3. Të publikojë aktet nënligjore në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, vendimet e ministrit të publikohen në ueb-faqen e ministrisë dhe të njëjtat t'u dërgohen drejtorive komunale të arsimit në kopje fizike dhe elektronike dhe DKA-të t'i përcjellin në të gjitha shkollat.

4. Të ngrejë kapacitetet e drejtorive komunale të arsimit dhe të shkollave për futjen e të dhënave SMI-a, t'i obligojë drejtoritë komunale të arsimit të bëjnë mbikëqyrjen e shkollave në futjen e të dhënave në SMI-a, me qëllim të adresimit të çështjeve të veçanta në secilën shkollë.

5. Të ndryshohet udhëzimi administrativ numër 16/2012 lidhur me pajisjen e nxënësve me tekste shkollore falas, përdorimi dhe ruajtja e tyre me qëllim të përfshirjes së masave dhe përgjegjësi për të gjithë pjesëmarrësit gjatë blerjes, shpërndarjes dhe pranimit të teksteve mësimore.

6. Të mbledhë nga drejtoritë komunale të arsimit raportet të detajuara për ngarkesat e shkollave me nxënës dhe në bazë të tyre të hartojë planin pesëvjeçar për ndërtimin e shkollave në zonat më të ngarkuara urbane. Ndërsa për shkollat rurale ku numri i nxënësve është i vogël të hartohet plani për ofrimin e transportit për në shkollën më të afërt, ku ofrohet cilësia më e madhe e mësimdhënies.

7. Të kërkohen nga drejtoritë komunale të arsimit të dhënat për numrin e saktë të braktisjes së shkollave, si dhe arsyet e braktisjes në nivel shkolle. Nga raporti me të dhënat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të nxjerrë udhëzimin administrativ me qëllim të përcaktimit të hapave që drejtoritë komunale të arsimit të ndërmarrin me qëllim të parandalimit të braktisjes.

8. Në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë Komunale të Arsimit përkatës të ndërmerren masa të veçanta për ofrimin e arsimit për të mitur në qendrat korrektuese.

9. Në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike në procesin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për shërbimin civil të evitojnë kolezionin e tij me legjislacionin nga fusha e arsimit, duke pasur parasysh specifikat e marrëdhënies së punës në arsim, rasti i pensionimit, sëmundjeve, e kështu me radhë.

10. Të ndryshojë formulën e financimit të shkollave, duke marrë parasysh specifikat e shkollave.

11. Të themelohet Agjencia e Kosovës për Kurrikula, Standarde dhe Vlerësim.

12. Të nxjerrë akte nënligjore për kurrikulat lëndore, si bazë për hartimin e testeve të reja mësimore.

13. Në bashkëpunim me Këshillin Shtetëror për licencimin e mësimdhënësve të nxjerrë udhëzues për procesin e rivlerësimit të mësimdhënësve gjatë avancimit në karrierë.

Sigurisht që këto rekomandime janë nxjerrë në bazë të asaj dhe lëshimeve të cilat faktikisht ne i kemi vërejtur gjatë periudhës së mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Bulliqi. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zonja Luljeta Veselaj-Gutaj.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës u jep mbështetje rekomandimeve nga Komisioni i Arsimit.

Meqenëse është një fushë shumë specifike dhe do të kishte qenë mirë për të na dhënë edhe më tepër sqarime në disa pika të cilat janë këtu si rekomandime, por nuk e kemi kryetarin e Komisionit dhe shpresojmë që do të vijë në ndërkohë dhe të na japë disa sqarime, megjithatë ne

u japim mbështetje rekomandimeve dhe kërkojmë nga kolegët deputetë t'i votojnë ato. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bulliqi nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

SHPEJTIM BULLIQI: Zoti kryesues!

Gjithsesi Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i mbështet të gjitha këto rekomandime dhe në emër të anëtarit të këtij komisioni jemi të gatshëm eventualisht për çdonjërin prej këtyre pyetjeve që mund të parashtrohen rreth atyre paqartësive që mund të jenë rreth këtyre rekomandimeve të japim sqarime adekuate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS nuk është paraqitur askush. Grupi parlamentar "6+", zonja Serbica Shinik.

MÜFERA ŞINIK: Teşekkür ederim. Eğitim, Bilim ve Teknoloji, Kültür, Gençlik ve Spor Komisyonu Kosova Cumhuriyeti Üniversite Öncesi Eğitimi hakkında hazırlamış olduğu raporun içeriğinde, Türkçe eğitimdeki ders kitapları yanı sıra, yardımcı ders kitapları, iş defterleri, haritaların Türkçe olmayışı göze vurmaktadır. Bunun dışında okullardaki yöneticilerin eğitim dillerini bilmemesi, pedagog ve psikologların olmayışı, ana okullarının eksikliği gibi noktalar göze batmaktadır, bunları rapora katarak, "6+" Parlamenter Grubu olarak Raporu kabul etmekteyiz.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Mjaku-Topalli e ka fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndiej për obligim të paraqes para jush disa çështje, duke e ditur se qëllimi i këtij ligji është parimi i aksesimit gjithëpërfshirës, të zbatohet në Republikën e Kosovës si praktikë më e mirë në përputhje me normat ndërkombëtare, atëherë do të ishte e nevojshme që MASHT-i t'i obligojë drejtoritë komunale të arsimit që të themelojnë një ekip profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore, të përbërë nga specialist të arsimit, punëtorë socialë, psikologë dhe të rehabilitimit.

Vlerësimi profesional shqyrton dhe përcakton nëse nxënësi ka nevojë për shkollim special apo nëse ai nxënës mund ta vijoje shkollimin në shkolla të rregullta.

Po ashtu, secili institucion duhet të ketë edukatorët mbështetës dhe mësimdhënësin mbështetës për fëmijët me nevoja të veçanta, të cilët e vijnë mësimin në shkolla të rregullta.

Po ashtu, rekomandimi i dytë që ka ardhur nga Komisioni për Arsim është që të nxjerrë udhëzimin administrativ për kodin e mirësjelljes vetëm për nxënës. Unë mendoj se do të ishte mirë që të plotësohet edhe me kodin disiplinor për mësimdhënësin.

Andaj, kërkoj nga anëtarët e Komisionit për Arsim, si dhe nga ju kolegë që t'i mbështetni këto kërkesa nga unë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Çështja e arsimit është një nga më të rëndësishmet në Kosovë dhe do të doja që ky debat ta merrte rëndësinë e vet edhe duke e pasur praninë e ministrit të resorit përkatës.

Natyrisht e vlerësoj punën që ka bërë komisioni në lidhje me monitorimin e Ligjit për arsimin.

Mirëpo, unë dua të ndalem veçanërisht në dy çështje që i konsideroj jashtëzakonisht të rëndësishme.

I përkrah rekomandimet që kanë të bëjnë me kurrikulumet, mirëpo ne duhet ta trajtojmë në mënyrë pak më të gjerë çështjen e kurrikulumeve në arsim, veçanërisht në lidhje me tekstet që po përgatiten vazhdimisht pas një lloj kriteri nga njerëz të cilët nuk i kanë thirrjet përkatëse për të përgatitur tekste, gjë që ka çuar edhe në hartimin e teksteve jashtëzakonisht konfuze për mendjen e nxënësve, me gabime nga më të ndryshmet, përfshirë edhe atë në aspektin gjinor, të cilat madje janë kapur si skandale nga vetë nxënësit, por edhe nga mediet.

E kemi sot për sot një logjikë të përgatitjes së teksteve vetëm e vetëm për shkak të tenderëve, ose kjo ka ndodhur në të shkuarën, pra që dikush ta fitojë një tender ose që t'i bëhet nder dikujt i jepet përgatitja e një teksti. Marrëzitet në përgatitjen e teksteve shtrihen deri aty sa unë personalisht kam pa që tekste shkencore janë marrë nga burimet e internetit nga wikipedia pas një lloj verifikimi, personalisht kam parë gabime pa fund shkencore. Të mos flasim pastaj për tekste që u përkasin shkencave sociale ku gabimet janë më të mëdha, por ndoshta më pak vihen re. Kështu që në mungesë të ministrit të Arsimit, unë do të doja që kjo çështje të trajtohet sërish. Nuk është e thënë që këtë çështjen e arsimit ta ngrejë vetëm opozita, por duhet ta trajtojmë edhe ne si pozitë, sepse është interes kombëtar.

Niveli i arsimimit në mbarë Kosovën lë jashtëzakonisht shumë për të dëshiruar dhe një nga problemet numër një është çështja e kurrikulave. Nxënësit janë jashtëzakonisht të ngarkuar me tekste pa fund, mirëpo me mungesë cilësie. Mësuesit trajnohen vazhdimisht, ka projekte që shpenzojnë me miliona euro për trajnim, mirëpo rezultatet vazhdojnë të jenë shumë negative. Pse? Sepse nuk punohet në bazë të një sistemi që me të vërtetë do t'i nxirrte vlerat në pah dhe do t'i merrte si njerëz të cilët hartojnë tekste, pikërisht ata të kualifikuarit.

Qeveria e Kosovës në këtë mandat, por edhe në mandatin e kaluar ka bërë një marrëveshje bashkëpunimi me Qeverinë e Shqipërisë dhe njëra nga fushat të cilat është përmendur që do të bashkëpunohet ka qenë fusha e arsimit dhe mendoj që kjo është dashur të bëhet shumë më herët, që pas përfundimit të luftës në Kosovë, në mënyrë që të hartohen tekste të përbashkëta, jo vetëm në shkenca, sepse ajo është jashtëzakonisht e lehtë në shkencat natyrore, por edhe në shkencat shoqërore. Ky bashkëpunim ka munguar dhe vazhdon të mungojë edhe aktualisht dhe secili të hartojë tekste diletante për hesap të vet. Ne nuk kemi si të presim rezultate të mira të nxënësit në rast se vetë tekstet - lënda bazë pra, janë shumë problematike. Prandaj, ndoshta çështja e kurrikulumeve duhet të jetë nga pikat kryesore të këtij raporti, por mendoj që duhet ta trajtojmë edhe në të ardhmen, në mënyrë që sa më me seriozitet ta trajtojmë çështjen e nivelit arsimor.

Nuk duhet të flas për gafa të tjera se ka shembuj pa fund që gjenden në tekste ose për vetë nivelin e mësimdhënësve, por besoj që ne si Kuvend duhet të ndërmarrim diçka, qoftë të kërkuar i llogarisë ndaj sferës së arsimit, por qoftë edhe të çështja e buxhetit nëse është e nevojshme të shpenzohet më shumë buxhet në arsimim, sesa nëpër rrugët e Kosovës ose në infrastrukturë, sepse e ardhmja pa një sistem të mirë të edukimi mund të jetë thjesht e zymtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Me kryetarin e Kuvendit, me shefin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kemi marrë qëndrim që ta shtyjme për një javë këtë raport dhe kryetari dhe shefi i grupit kanë munguar, sa për njoftim, dhe kjo është një gjë për keqardhje se nuk kemi deputetë të mjaftueshëm as ta diskutojmë, as ta debatojmë, e as ta arrijmë atë votim.

Mendoj që ky raport është më serioz sesa e bëjmë ne deputetët në sallë. Por, megjithatë, të drejtën e leximit e kemi.

Për ne është me rëndësi që të shqyrtohet, t'i jepet rëndësia dhe pesha. Këtu e shoh që raportit nuk i është dhënë rëndësia, meqë Komisioni e ka bërë një hulumtim disa muaj në këtë ligj. Prandaj, e shoh që është diçka e kotë të diskutojmë në formë të tillë.

Pa një seriozitet të mirëfilltë të trajtimit të çështjes së arsimit, është e kotë. Kanë kërkuar dhe kemi kërkuar ta shtyjme, por njerëzit nuk e kanë bërë, prandaj e shoh të paarsyeshme të diskutojmë më tutje.

Prandaj, unë kërkoj që të shqyrhet për një javë diskutimi në një pikë të seancës së re dhe të dilet me qëndrim, të vijë ministri këtu dhe të marrë përgjegjësi. Nëse është çështja veç të bëjmë një llaf këtu në Kuvend dhe të themi që e kemi trajtuar, cila është arsyeja që ne ta bëjmë monitorimin e ligjeve.

KRYESUESI: Nait, ne i kemi shtyrë disa pika me votim dhe seanca ka të drejtë ta e shtyjë, po ju nuk keni paraqitur kërkesë, as Komisioni, as ti për ta shtyrë. Tani kjo ka hyrë në rend të ditës dhe ne jemi të obliguar që konform Rregullores të procedojmë. Askush s'ia ndalon askujt për ta thirrur një debat lidhur me këtë çështje dhe të debatohet edhe një herë, kur të duam të gjithë të debatojmë. Unë nuk kam mundur ta heq, se mua më tregoi edhe sekretari që keni biseduar lidhur me këtë çështje, por ju s'ia keni paraqitur seancës kërkesën dhe seanca nuk e ka shtyrë. Kjo është ajo që dua ta them.

Nait Hasani, edhe diçka do të shtojë.

NAIT HASANI: Nënkryetar, seanca ka filluar në formë të parregullt që në fillim. Kur ka filluar në mënyrë të parregullt për çështjen e votimeve, nuk ka shkuar me rend të ditës që ne ta kemi mundësinë për të kërkuar tërheqjen, e kjo ka qenë arsyeja që ne kemi shkuar me votime të prioriteteve që janë përcaktuar, e jo me prioritet arsimin.

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Nuredin Ibishi.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë po e shoh këtu, domethënë 13 pika apo 13 rekomandime për të cilat nuk e kam të qartë, pasi edhe zoti Hasani e parashtroi që nuk kanë çështje ende për të debatuar, apo edhe pse ne e kemi marrë raportin si të tillë dhe s'janë bërë kërkesat me kohë për ndryshim të rendit të ditës, ku ta di unë.

Por, sido që të jetë, mua po më intereson një - nëse vazhdojmë për ta shqyrtuar raportin lidhur me këto rekomandime a ka kërkesë për amendamentim domethënë të vetë ligjit për arsye se mendoj se në shumë pika prek edhe në amendamentim sa e shoh unë, e unë desha konkretisht t'i drejtohem zotit Hasani lidhur me pikën apo rekomandimin 1-5, që ka të bëjë me ndryshimin e udhëzimit administrativ nr. 16/2012 lidhur me pajisjet e nxënësve me tekstet shkollore falas, përdorimi dhe ruajtja e tyre me qëllim të përfshirjes së masave dhe përgjegjësive për të gjithë pjesëmarrësit gjatë blerjes, shpërndarjes dhe pranimit të teksteve mësimore, për arsye se e di që ka pasur shumë keqpërdorime këtu. Pra, a kërkon kjo ndryshim edhe të ligjit bazik, apo vetëm udhëzimi administrativ e mbulon këtë?

Dhe çështja tjetër është te rekomandimi i fundit, te rekomandimi 13, ka të bëjë me bashkëpunimin me Këshillin Shtetëror për licencimin e mësimdhënësve të nxirret një udhëzues për procesin e vlerësimit të mësimdhënësve gjatë avancimit në karrierë. Mendoj që kjo ka ekzistuar, vetëm nëse ndoshta aspekti i bashkëpunimit ndërmjet Këshillit Shtetëror për licencimin e mësimdhënësve, ka ekzistuar edhe më herët, edhe domethënë edhe në praktikë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë mendoj se prapë ashtu siç e thashë në fillim, ky debat nuk po ka efektin e vet, ngase personi kyç, figura kyçe - ministri i Arsimit mungon këtu dhe ne e dimë rëndësinë që ka ky komision, ky raport që paraqet gjendjen e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës. Unë mendoj që punën që e kanë bërë deputetët është një punë e mirë, por fatkeqësisht pa rezultat.

Pse them pa rezultat? Për faktin se nuk mbahet në mend në këto dy legjislaturat e fundit që ministria, konkretisht Qeveria e Kosovës e ka zbatuar ndonjë rekomandim që ka dalë nga Kuvendi i Kosovës. Prandaj, edhe këto rekomandime që kanë dalë nga ky komision do të mbeten vetëm në sirtarin e Qeverisë, konkretisht në Ministrinë e Arsimit, dhe nuk zbatohen në terren, e veçanërisht në këtë mandat, kur Qeveria e ka shumicën absolute dhe është një koalicion i gjerë, prandaj ne si Kuvend jemi shumë të pafuqishëm përballë ndryshimeve konkrete.

Mendoj se komisioni, përveç që e ka mbikëqyrur punën, konkretisht gjendjen e arsimit, është dashur edhe një çështje ta vërë në pah - gjendjen e rëndë në përgjithësi në arsimin parauniversitar të Kosovës. Gjendja nuk është shumë e mirë. Ne e dimë, duke filluar nga principet themelore, kushtet themelore, siguria e nxënësve kryesisht rrugën që e bëjnë për të shkuar në objektet shkollore, pastaj në sistemin vetë arsimor parauniversitar, vite me radhë fatkeqësisht tekstet janë shkruar nga personat politikë dhe joprofesionistë. Merrini shikoni të gjitha tekstet në arsimin parauniversitar, veçanërisht ato të klasave më të ulëta, e do të shihni se në ato tekste ka edhe

nxitje për urrejtje, për përçarje, bile-bile në shkallë më të rëndë, shkallë më ekstreme ku nxiten edhe vrasjet.

Prandaj, çështja e teksteve duhet të mbikëqyret jo vetëm nga komisioni parlamentar, por duhet edhe të hetohet. Por, fatkeqësisht, tekstshkruesit kanë marrë tenderë dhe kanë marrë para të mira nga Ministria e Arsimit, e fatkeqësisht ata tekstshkrues nuk janë profesionistë, por janë persona politikë.

Unë mendoj që ne si Kuvend në kuptim plotë i kemi humbur gjitha betejat, edhe këtë betejë përballë Qeverisë së Kosovës, ngase këto rekomandime të nxjerra nga puna e kolegëve deputetë të nderuar që e kanë bërë një punë të mirë, nuk do të sjellë kurrfarë benefiti, kurrfarë produktiviteti, ngase nuk do të gjejë zbatim në praktikë sikur shumë rekomandime të komisioneve të tjera dhe mungesa e ministrit të Arsimit e bën edhe më të padobishëm këtë debat, prandaj këto do të mbeten të shkruara dhe kurrë të zbatuara.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Shumë shkurtimisht, ndoshta veç në funksion të përforsimit të kësaj çka e thanë edhe kolegët tjerë.

Është e vërtetë që sot do të duhej të ishte ministri i Arsimit këtu, mirëpo ndoshta nuk e ka parë të nevojshme, ose komisioni nuk ka qenë shumë insistues në këtë drejtim. Kam frikë që komisioni, përderisa nuk e ka bërë një propozim për debat në Parlament këtu, gati që janë të pavlefshme, gati që janë krejt formale krejt rekomandimet, të cilat i kanë shkruar dhe rekomandimet që e kanë paraqitur për ministri. Bile po më habit fakti pse kolegu Bulliqi nuk e ka shkruar në fund edhe një rekomandim, a ka ministër të Arsimit, apo jo?

Në fakt, problemi kryesor dhe problemi esencial kujtoj që qëndron në çështjen e cilësisë së arsimit aq shumë të proklamuar nga shumë qeveri, edhe nga kjo Qeveri, nga ministrat e arsimit vazhdimisht në të gjitha qeveritë. Edhe në fakt, vazhdimisht ne, çalimin më të madh e kemi në cilësinë e arsimit. Mjetet më të mëdha gati shkojnë krejt dikah tjetër, e më së paku i kushtohet kujdes dhe rëndësi cilësisë së arsimit, që është çështja më esenciale. Edhe në fakt, ne kot po kërkojmë nëpër fakultete, nëpër universitete, nivele të larta të studentëve, përderisa nuk po merremi me atë fillestar, nuk po merremi me nivelin më fillestar, sepse aty fillon problemi, aty fillojnë telashet. Librat shkollorë, fatkeqësisht, në pjesë shumë të madhe janë libra joshkencorë. Unë për vete jam shumë e brengosur për këtë çështje, më ka rënë t'i shohë disa nga librat, disa të historisë, ndoshta diku një edukatë qytetare, jo ndonjë libër tjetër, por janë thjesht libra të cilët është për të ardhur turp pse ti ke mësuar diçka në një kohë të caktuar, kur megjithatë kanë qenë do kritere dhe kemi ardhur në një periudhë kur nuk ka asnjë kriter shkencor. Janë kritere të interesave ditore, në fakt nuk janë kritere hiç, por janë çështje, qoftë të animeve, qoftë thjesht një politizim i librit.

Kjo është e papranueshme, a? Jo veç e papranueshme, por është diçka që nuk guxon të ndodhë kurrë në asnjë vend, në asnjë shtet demokratik. Nuk guxon të ndodhë as në vendin tonë.

Prandaj, unë mendoj që komisioni, me gjithë punën që e ka bërë, po vlerësoj që megjithatë ka bërë punë të mirë dhe ka dhënë rekomandime të mira, mirëpo këto rekomandime mund ta kenë vlerën, mund të shtohen, mund të hiqen, mund të korrigjohen vetëm me një debat. Ndoshta komisioni do të duhej që të kërkonte, por edhe të tjerëve nuk u ndalohet që ta kërkojmë një debat për arsim. Bile-bile do të ishte mirë që krejt këto vlerësime, të cilat po bëhen për zbatimin e ligjeve në të gjitha fushat, në fund thjesht të rezultojnë me debat, sepse pa debat këto më janë veç formale, janë veç formalitet. Kjo është nën një.

E dyta, unë do të ndërlidhem edhe me një çështje, e cila nuk është përmendur as në rekomandime. E di që është çështje më shumë politike, por që ministri e ka proklamuar shumë dhe ka kërkuar shumë që do ta realizojë. Është çështja e pajisjes me libra shkollorë të qytetarëve shqiptarë në Luginën e Preshevës.

Me gjithë garancinë, në njëfarë mënyre garanci ka dhënë ministri se do të pajisen, unë nuk e di që ata fëmijë janë pajisur me libra shkollorë. Mund të mos kem informata të bollshme, ndoshta edhe janë pajisur, por me sa di unë nuk është bërë një gjë e tillë, dhe bile-bile ka pasur probleme edhe të kalojë ministri etj., etj. Dikush thotë kjo mund të jetë çështje e bisedimeve Kosovë-Serbi e tjera, por unë nuk e di a do të jetë çështje e bisedimeve apo jo, por e di që është obligim shumë i rëndësishëm dhe një detyrë e rëndësishme që t'u dilet në ndihmë qytetarëve, fëmijëve, nxënësve shqiptarë të Luginës së Preshevës, sepse janë të vetmit në krejt hapësirën shqiptare që nuk kanë libra të duhur për shkollim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Veselaj-Gutaj përsëri e ka fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Kryesues!

Unë e kam një rekomandim konkret që t'u bashkëngjitet rekomandimeve tjera të monitorimit të Ligjit për arsimin e parauniversitar. Të obligohen DKA-të për angazhimin e stafit profesional, siç është pedagogu dhe psikologu në çdo shkollë, sepse është domosdoshmëri që të angazhohen dhe të jetë një staf funksional profesional në shkollat tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Unë po mendoj dhe po më duket që kemi përzierje të temave, e cila trajtohet sot dhe ajo çka po dëshirojmë edhe që është çështje tjetër e një debati më të gjerë - cilësia në arsim çfarë e kemi sot.

Ky raport ka të bëjë për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës. Nuk matet me këtë raport, qoftë cilësia, qoftë kërkesat tjera, apo edhe mendimet, qofshin ato individuale, profesionale dhe të futjes së ndonjë logjike ndryshimi në arsimin parauniversitar. Komisioni e ka pasur për detyrë që ta mbikëqyrë a zbatohet ky ligj apo jo, dhe ky është rekomandimi kryesor që i mungon, sepse në brendinë e raportit ka shumë nene, të cilat këta vetë i kanë konstatuar që nuk zbatohen. Ndërsa, me rekomandime asnjë nuk është dhënë, nuk është saktësuar se cili nen duhet të zbatohet, apo duhet të rekomandohet zbatim i tij, qoftë me akt nënligjor, qoftë me nenin e përcaktuar, siç e përcakton ligji.

Ndërsa, ne e kemi mundësinë që ata që mendojnë që cilësia në arsim apo kanë ide shumë më të mira se sa aktualisht, duhet ta thërrasim një debat, t'i përcaktojmë temat dhe Kuvendi mundet të rekomandojë ndryshim të ligjit dhe ndryshim të sistemit arsimor, nëse e arrijmë atë votën e kualifikuar. Andaj, unë mendoj që kjo është për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe komisioni ka bërë një punë të mirë, e ka konstatuar ku janë ato, por te rekomandimet shumica janë të përgjithësuara, disa dalin edhe nga ato kërkesat që mendojnë që duhet të jenë pjesë e zhvillimit më të mirë, apo ta them ngritjes së cilësisë së arsimit parauniversitar.

Unë mendoj që një prej rekomandimeve kryesore është të zbatohet ligji. Nëse nuk kemi zbatim të këtij ligji, atëherë duhet të kërkojmë plotësim-ndryshim të këtij ligji në pikat për të cilat i ngrehën shqetësimet edhe deputetët në aspektin individual. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bulliqi edhe një herë.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, kryesues!

Unë s'e pata në plan të diskutoj, por meqë u diskutua prej disa kolegëve çështja dhe dukja paksa formale e këtyre rekomandimeve, por edhe versionet e ndryshme rreth testeve mësimore, e kështu me radhë, ç'është e vërteta komisioni gati për një vit të tërë ka punuar në mbikëqyrjen e këtij ligji. Bashkërisht janë realizuar një numër i madh i vizitave në terren për ta parë gjendjen për së afërmi të zbatimit të Ligjit për arsimin parauniversitar dhe në bazë të krejt atyre të gjeturave, të cilat i kemi arritur t'i konstatojmë në terren, faktikisht ne kemi dalë me këto rekomandime.

Unë pajtohem pjesërisht me disa prej kolegëve që thonë që tekstet tona shkollore nxitin edhe gjuhë në atë formë çfarë u tha këtu, sepse nuk është e vërtetë krejt ajo. Ne mund të themi që nuk jemi të kënaqur me tekstet mësimore, edhe me përmbajtjen e tyre programore, por pa dashur tash ta amnistoj askënd këtu në këtë rast, ju e dinë shumë mirë se këto tekste mësimore nuk janë tekste të kësaj ministrie, ose të këtij ministri në mandatin e tij. Këto tekste mësimore janë nxjerrë shumë më herët dhe sot e kësaj dite vazhdon ribotimi i tyre, me gjithë faktin që vetë ministri i Arsimit në fakt në këtë kohë është deklaruar që do të bëjë ndryshimin e këtyre teksteve mësimore, por në bazë të disa informacioneve nga terreni mendohet që në njëfarë forme të merren prapë të njëjtat autorë, të njëjtat tekste, në njëfarë forme të rishkruhen, të bëhet heqja e disa pjesëve nga këto tekste mësimore, kështu që mendoj që nuk do të jetë zgjidhje në të ardhmen për arsye se e vërtet me kurrikulën e re, që është në zbatim dhe ka filluar në formë të pilotimit në disa prej shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, atëherë domosdoshmërisht është dashur që kjo kurrikulë e re të përcillet edhe me ndryshimin e teksteve mësimore konform saj.

Përndryshe, në qoftë do të na mbeten të njëjtat tekste mësimore, sigurisht që nuk do të jetë zgjedhje e problemit. Ndërsa, një pyetje të cilën e bëri kolegu Ibishi rreth rekomandimit të dytë për ndryshimin e udhëzimit administrativ 16/2002 për pajisjen e nxënësve me tekste mësimore, këtu është menduar që faktikisht buxheti i Kosovës për çdo vit ndan një shumë relativisht të madhe të parave dhe faktikisht këto ndahen për blerjen e teksteve të reja mësimore dhe kemi menduar që ndoshta këtu duhet të bëhet një ndryshim, në mënyrë që të kursehet ky buxhet që të mos blihen për çdo vit tekste të reja mësimore për arsye se të paktën ka mundësi këtë ta bëjmë çdo dy vjet, për shkak se ka mundësi një vit të shfrytëzohen tekstet e reja mësimore dhe vitin tjetër të shfrytëzohen po të njëjtat tekste të përdorura, eventualisht me ndonjë problem që mund

të paraqitet me disa tekste mësimore, kështu që në njëfarë forme ta kursejmë buxhetin e Kosovës. Kjo është menduar.

Ndërsa, sa i përket çështjes së angazhimit të personelit pedagogjik dhe psikologjik nëpër shkolla, na është premtuar nëpër takimet, të cilat i kemi pasur me ministrin e Arsimit, që konform mundësisë buxhetore që ka, nga viti në vit të zgjerohet ky numër i njerëzve të cilët do të kyçen në proces në shkolla dhe besojmë që brenda një afati relativisht të shkurtër kohor do të ketë mundësi që çdonjëra shkollë ta ketë pedagogun, edhe psikologun, gjë që do të ndihmojë në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Morina e ka fjalën.

SALI MORINA: Faleminderit, kryesues!

Po mendoj që deputeti Zemaj pak a shumë e sqaroi më detajisht çështjen e kësaj pike. Nëse është e vërtetë që Komisioni për Arsim ka bërë monitorimin do të thotë të Ligjit për arsimin parauniversitar dhe problemet e arsimit në Kosovë nuk mund të sqarohen, ose nuk mund të diskutohen, ose të shqyrtohen vetëm nëpërmjet këtij ligji.

Pra, ka probleme shumë më të mëdha se sa që janë përcaktuar, nëse sqarohen nëpërmjet këtij ligji. Ne realisht i kemi përcaktuar, i kemi nxjerrë 13 rekomandime në bazë të monitorimit që e kemi bërë brenda një viti. E tha edhe kolegu Bulliqi, i kemi nxjerrë 13 rekomandime dhe deputetët gjatë këtij diskutimi mund të japin rekomandime, mund të shtojnë rekomandime, por problemin e arsimit në përgjithësi s'mund ta rrahim në këtë pikë, me të cilën ne i kemi nxjerrë këto 13 rekomandime.

Mendoj që komisioni nuk ka asnjë obligim sot t'u përgjigjet deputetëve në pyetjet që po bëhen. Ata mund të japin sqarime, ose mund të japin rekomandime që të futen, të pasurohet me këto rekomandime që i kemi dhënë ne, por nuk është detyrë, nuk është obligative që ne si komision t'u japim përgjigje sot deputetëve, të cilët po bëjnë pyetje në kuadër të kësaj pike, sepse përgjigjet mund t'i japë vetëm ministri. Ai është institucioni përkatës, ai është personi përgjegjës.

Prandaj, unë isha pajtuar me shumë parafolës deputetë këtu që ndoshta një të ardhme shumë të afërt ta bëjmë një debat të përgjithshëm për arsimin në përgjithësi në Kosovë, për cilësinë e arsimit dhe për çështjet tjera që janë të rëndësishme për fushën e arsimit, por sot unë kërkoj nga deputetët që këto 13 rekomandime që i kemi dhënë të votohen dhe pastaj të kërkohej debati, por jo nga komisioni, sepse komisioni më së paku brenda kësaj periudhe diku mbi 7 herë e ka ftuar ministrin e Arsimit në komision edhe për çështjen e literaturës, e librave për pjesën e Preshevës dhe Medvegjës, edhe për shumë çështje të tjera që kanë qenë të ndjeshme, ne si komision e kemi kryer punën tonë, sepse ekzistojnë proceset, procesverbalet.

Prandaj, do të ishte mirë që në këtë rast këto rekomandime që i kemi dhënë ne të vlerësohen nëse janë të mira apo nuk janë të mira. Kjo mbetet për deputetët të cilët edhe i shtuan dhe i pasuruan këto rekomandime të votohen dhe pastaj në një të ardhme ta ftojme ministrin, ta futim në pikë të rendit të ditës, domethënë të ftojme debat për arsimin në përgjithësi në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

I përsërisht të gjithë deputetët që janë të pranishëm në sallë, sidomos kolegët që kontribuan me dhënien e rekomandimeve konkrete, por unë e kam një pyetje për anëtarët e komisionit: A është shqyrtuar ky raport në Komisionin për Arsim, apo jo, sepse tash po dalin dilemat ose të shtyhet, ose po japin propozime tash këtu.

Ne si deputetë që nuk kemi qenë pjesë e komisionit kemi të drejtë, por edhe një herë për anëtarët e komisionit - a e keni shqyrtuar dhe a ka kaluar në Komisionin për Arsim ky raport?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha e ka fjalën.

VETON BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqenëse u hap debati, atëherë edhe unë po pajtohem me parafolësit që ia vlen të jetë një pikë e veçantë dhe të diskutohet, sepse është fushë jashtëzakonisht e rëndësishme që përfshin të gjitha grupet dhe të gjitha komunitetet, dhe mendoj që kjo është një prej ligjeve më të rëndësishme, e cila do kontributojë nga secili deputet, pavarësisht a jemi në Komisionin e Arsimit apo jo, sepse këtu është i vetmi rast që po kemi mundësi ta diskutojmë dhe pajtohem që do të duhej të shtyhej për një ditë tjetër, ku duhet të jetë patjetër i pranishëm ministri.

Unë po i referohem rekomandimit 1.7 që flet për braktisjen e nxënësve në shkollë dhe komisioni ka rekomanduar që të jepet numri i saktë. Unë mendoj që te kjo fushë ligji do edhe ndërhyrje, do amendamentim, sepse te çështja e braktisjes së procesit mësimor, siç dihet ligji e parasheh mësimin fillor si mësim i obligueshëm. E unë mendoj që në kuadër të këtij ligji nuk ekziston një mekanizëm i kontrollit dhe i sanksionimit, apo i formave të tjera të cilat në rast se fëmija braktis procesin mësimor cili është mekanizmi i parandalimit, apo i kthimit të fëmijës në shkollë. Me çfarë pike, ose në çfarë forme ligji e ka paraparë që familjet, ose vetë shoqërinë ta obligojë dhe ta kthejë fëmijën në shkollë.

Unë mendoj që s'ka asnjë mekanizëm, sepse po flas nga praktika qysh nga viti i kaluar ka akoma fëmijë, të cilët ne ia kemi rekomanduar me listë Ministrisë së Arsimit që të ndikojë tek ato familje dhe t'i kthejë fëmijët në shkollë. Ata fëmijë akoma nuk janë, po flasim për shkollën fillore "Xhemajl Kada" në Pejë, më saktësisht, ku rreth 55 nxënës brenda vitit e kanë braktisur procesin mësimor dhe ne akoma nuk kemi pasur ndonjë mekanizëm prej ministrisë, se cila ka qenë forma e kthimit të atyre fëmijëve në shkollë.

Unë mendoj që edhe këtu duhet ose të rekomandojmë, domethënë që ministria ta planifikojë formën e sanksionimit, apo formën se si do të duhej që fëmijët të kthehen në shkollë, e mendoj që ka hapësirë edhe për amendamentim të ligjit. Andaj, pa dashur ta zgjas tani shumë, nëse vendosin që këtë pikë ta shtyjmë dhe ta diskutojmë edhe një ditë tjetër, mendoj që ia vlen, në mënyrë që vetë ministri t'i marrë këto rekomandime drejtpërdrejt dhe ndoshta të bashkëbisedojmë e të kemi mundësi edhe ne të kontribuojmë, por kjo fushë dhe kjo pikë është shumë e rëndësishme që mekanizmi i sanksionimit të çështjet e braktisjes dhe të mënyrës së kthimit të fëmijëve në shkollë është shumë e rëndësishme.

Andaj, nëse ka mundësi komisioni që akoma të fusë një rekomandim dhe të propozojë që vetë ministria dhe vetë DKA-të ta krijojnë një mekanizëm funksional, i cili detyron qoftë me ndalesa sociale, qoftë me format e tjera. Unë e di që praktikat në Evropë janë shumë të mira dhe të pranueshme, ku nuk ekziston asnjë fëmijë i cili nuk shkon në shkollë. Atëherë, ka mundësi edhe këtu që e njëjta praktikë të aplikohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një herë kryetari i komisionit e ka kërkuar fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Unë mendoj që duhet ta shtyjme për një javë dhe ta debatojmë edhe pranë ministrit, pranë kryeministrit, sepse është një ligj më i rëndësishëm i shkollës parauniversitare. Përndryshe, ky debat që është bërë e ka vlerën e vet në aspektin politik, por në aspektin për njerëzit që duhet të marrin vendime duhet t'u thuhet drejtpërdrejtë t'i dëgjojnë edhe të tjerët, t'i dëgjojmë edhe arsyet e ministrit. Është mirë që ta kemi ministrin këtu dhe ai të prezantojë me reagimet e veta politike, apo me reagimet të cilësisë, siç ka deklaruar deri më tash.

Prandaj, kërkoj që të shtyhet ky debat për një mbledhje të radhës pas një jave dhe të vijë ministri, ose në seancën e radhës, kurdo që të vijë, dhe ta shohim e ta diskutojmë, ta debatojmë, e t'i japim rekomandimet dhe këto rekomandime që i plotësuan apo i dhanë kolegët këtu janë të mira secila. Ne kemi punuar një vit në këtë aspekt, në këtë fushë të ligjit, kemi shkuar dhe kemi vizituar shkolla, kemi vizituar drejtorë të shkollës, mësues, shkollat private, shkollat publike, të gjitha i kemi parë, formën e punës së tyre, të metat e tyre, prandaj ta kalojmë në këtë formën kështu, veç të ecim, edhe ministri të mos jetë i pranishëm, më duket e paarsyeshme. Është një logjik ndoshta jo e shëndoshë e punës sonë në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Është shumë e vërtetë që kjo temë është shumë e ndjeshme dhe shumë e rëndësishme. Megjithatë, unë e falënderoj komisionin për punën që e ka bërë dhe natyrisht që për çdo dikaster të Qeverisë së Republikës së Kosovës komisionet e caktuara janë të obliguara t'i monitorojnë, qoftë ligjet, qoftë punën e tyre.

Unë s'po mund ta kuptoj sot kolegun tim zotin Nait, i cili është kryetar i komisionit, i cili e ka bërë punën adekuate dhe natyrisht që ne i kemi procedurat. Ne këtu nuk e kemi personale ta kemi ministrin, ai është i obliguar t'i respektojë rekomandimet e komisionit dhe ne si deputetë e kemi mundësinë tjetër ta thërrasim në debat për çështje të caktuara ministrin dhe kemi për çka ta thërrasim. Por, unë sot s'po mund të ju kuptoj ju personalisht për çka po kërkon punën tonë këtu, qëndrimin tonë këtu, vëmendjen tonë, përkushtimin tonë, të këtyre deputetëve që jemi këtu, që ju thoni ta shtyjme dhe ka hyrë pikë e rendit të ditës. Ju keni munguar në mëngjes të propozoni për ta ndryshuar këtë pikë të rendit të ditës, nuk keni qenë sigurisht këtu fare, as tash kur u diskutua për këtë pikë dhe disa deputetë që sot nuk e di ku janë, a në fushatë a ku janë, dhe ju duket më e rëndësishme sesa të jenë këtu dhe të diskutojmë për pikat e rendit të ditës.

Unë konsideroj që në qoftë se ne e kemi kuorumin duhet t'i votojmë rekomandimet, me votimin e rekomandimeve ne obligojmë ministrin t'i respektojë ato dhe pastaj për çështje të caktuara në

Ministrinë e Arsimit dhe konsideroj që kur të vijë raporti i Qeverisë për vitin 2015 ne duhet të përgatitemi si deputetë dhe të diskutojmë për performansën e dikastereve të caktuara, sepse jo të gjitha dikasteret janë njëjtë dhe po punojnë njëjtë dhe ne kemi jo vetëm të drejtë, por obligim t'u tregojmë ministrive tona kush e ka performansën pozitive e kush nuk e ka. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hasani replikë ka kërkuar.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

E falënderoj kolegën Besa, por ajo ka harruar që ka vija të kuqe. Prandaj, ato që kam kërkuar zgjedhje, këto janë vijat e kuqe, dhe këto vija të kuqe duhet të respektohen, sepse mungesa e deputetëve në Kuvend, edhe e koalicionit, tregon se ka vija të kuqe ku duhet të zgjidhen këto çështje.

Prandaj, punën që e kemi bërë ne, e kemi bërë pikërisht për të marrë vendime, e jo për të bërë veç një punë për të ardhur sa për të deklaruar këtu edhe ta mbajmë një raport politik.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zonja Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Kolegu im deputet!

Unë të jam përgjigj edhe nëpërmjet portaleve të Kosovës për këtë që e the sot, e tash po ma përforcon mendimin të të them që ai ka qenë deklarim i tipit Nait Hasani. Është edhe sot dhe këqyre, edhe kamerat ju lutem, këqyri deputetët, kolegët tu të partisë tënde ku i ke. LDK-ja i ka të gjithë këtu.

KRYESUESI: U krye, Nait! Faleminderit për diskutimet, s'je paraqitur. Zoti Hamiti e ka kërkuar fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë të nderuar,

Së pari, t'i japim logjikë punës sonë e të mos flasim me impulse. Ky rend dite është propozuar nga Kryesia, ky rend dite është aprovuar nga Kuvendi.

Dhe, të gjitha diskutimet tjera mund të jenë vlerësime personale, por nuk thonë gjë kur të vendosë Kuvendi, nën një. Që kur ka hyrë në rend dite është konsideruar që ka rëndësi të veçantë dhe s'ka nevojë ta riemërojmë rëndësinë secilën herë për secilën pikë. U tha këtu që është diskutuar dhe është punuar shumë derisa është krijuar ky raport. U lexuan edhe rekomandimet, Kuvendi miraton rekomandime, që gjithmonë janë tekste themelore dhe bashkë me to raportin, sepse nuk mund njëra pa tjetrën.

Të gjithë deputetët, ashtu si edhe unë, i kanë pasur në dorë këto tekste dhe po të kenë qenë kaq të motivuar ta dinë, i dinë. Ka njerëz që i lexojnë, ka njerëz që s'i lexojnë kurrë. Ka njerëz që i lexojnë veç rekomandimet dhe është mirë që të tregojnë. Nuk është keq.

E dyta, ky diskutim po flet për të gjitha aspektet e arsimit dhe vërtet në Kuvend mund të flitet edhe ashtu. Por, tema është zbatimi i një ligji që është në fuqi. Pse po insistoj këtu? Po insistoj se ju i dini këto, po nganjëherë rrëmbehemi për ta thënë ndonjë ide dhe harrojmë.

Ministrin keni të drejtë ta thërrisni në interpelancë dhe mund të flitet tri orë për këtë problem dhe Kuvendi mund të thërrasë seancë tematike për arsimin, në të cilin mund të flitet derisa të shteret diskutimi. Pra, nuk kemi nevojë ta bëjmë çështje a mund ta thërrasim në zotin Arsim Bajrami këtu. Të gjitha mekanizmat i kemi. Nuk ka mbetur problemi i rekomandimeve të zbatimit të një ligji që është në fuqi, që është më i madh edhe se ministri, që ta thërrasim Arsim Bajramin. Normalisht, mirë do të ishte t'i dëgjojë rekomandimet.

Pse i përmenda dy mundësitë tjera? Dy mundësi të tjera prodhojnë obligime shumë më shumë. Një shqyrtim i raportit të ligjit propozon rekomandime që një ministër të mençur dhe të kujdesshëm e shtynë të lexojë kujdesshëm, por rekomandimi nuk është tekst obligues si dokument i Kuvendit. Këshillues, sugjerues, po. Prandaj, bëjeni dallimin ndërmjet nevojës për ndryshimin e ligjit, që është krejt tjetër punë, ju mund ta sugjeroni, dhe të zbatimit të ligjit në fuqi. Janë dy çështje krejt të ndryshme. E thashë me qëllim “ndryshimin e ligjit”. Ju e dini që Ligjit për arsim, edhe ai parashkollor dhe ai i shkollimit të lartë, janë ligje që quhen “me rëndësi vitale”, i thonë në Kushtetutë. Dhe, ju e dini shumë mirë që ai i larti ka ardhur tri herë dhe s'ka kaluar dhe ju e dini pse, sepse do votim të dyfishtë. Njësoj është për tjetrin, dhe nuk është mirë ta kthejmë nevojën në propagandë, që nuk bën rezultat.

Këto ligje, nëse kanë nevojë, e në disa pika bien, jam i bindur, që kanë nevojë që të ribëhen, ose të plotësohen, duhet të ribëhen me konsensus të Kuvendit, ndryshe s'bëhen. Dhe, duhet të ribëhen, sepse ka probleme që jeta konkrete në një lëmi, në një shoqëri, në një shtet si ne kërkon ndryshime. Unë këtu po e pushoj diskutimin për këtë problem.

Pra, unë pranoj që mund të diskutohet edhe për sistemin e arsimit, por për të diskutuar për sistemin e arsimit duhet të ndërrohet ligji. Tjetër është problemi sistemi i arsimit, që është i kodifikuar me ligj, që i thonë “panevropian”, sistemi “5,4,3” ju e dini, të gjithë kemi thënë, të gjithë e kanë, e bëmë edhe ne. Domethënë, formalisht, skematikisht, ligji s'ka pse ndërron, dhe nuk duhet të ndërrojë shpejt, sepse sistemi i arsimit është provuar kudo, edhe te ne është provuar, që është sistem për nga natyra shumë konservativ, nuk ndërron përditë. Ai që ndërron shpesh, i bie që s'ndërron kurrë kurrigjë. Veç krijon mjegullinë. Kështu që për ta bërë një propozim ndryshimi, përgatitjet e parapërgatitjet duhet të jenë shumë të forta e profesionale, në mënyrë që pasojat e fuqishme të ndihen pas një decenie.

Këtu po shoh që njerëzit kujtojnë që sot e jep një ide, e nesër realizohet. Jo, s'ka shans, për shkak se kurrikula është problem tjetër, sistemi është problem tjetër, ligji është tjetër. Ju e dini, kur komunikohet, për të pasur sukses, duhet ai që flet dhe ajo që flitet dhe ai që dëgjon të jenë në një sintoni. Cilido nga këto tri elemente, nëse ka dobësi, nuk funksionon, që i bie: kurrikula, profesori, edhe nxënësi, ose studenti, si të doni, të gjitha këto janë vlera të ndryshueshme nga një shoqëri në tjetër, nga një ambient në tjetër, nga një nivel shkollor në tjetrin.

Po them, mund të bisedojmë ne sot, t'i përmendim këto, por janë tema që shtrohen krejt ndryshe.

Dhe, puna e teksteve, unë e di që është pak “modë” të thuhet “s'janë të mira”, e çfarë të mira, të përsosura jo se jo. Po, veçse, asnjë tekst në mënyrë arbitrare në asnjë shkollë nuk ka kaluar. Të gjithë kanë recensione, recensione profesioniste dhe nënshkrim të tekstit të licencuar, ose të akredituar të qeverive, cilëndo. Nuk është me rëndësi a është ky ministër, a ai. Pra, nëse duhet të

përmirësohen, po, por nuk mund të thuhet që i është tekur dikujt dhe një tekst e ka nënshkruar një qeveri, ose një ministër. Unë nuk besoj, se ato me ligj bëhen.

Dhe, e dyta, nëse janë kaq të këqija ato tekste, qenka mirë që s'ua çojmë atje ku thatë. Pse t'ua çojmë tekstet e këqija? Le të kemi kujdes çka po themi! Jo, ne i kemi tekstet jo ideale, po tekstet optimalisht të mira, me mundësitë që i kemi. Dhe kini kujdes, edhe këto tekste kanë dallime, tjetër janë shkencat ekzakto. Teorema e Pitagorës është njësoj, si në Amerikën Latine, si në Japoni, si te ne. Shkencat shoqërore humanitare dhe sidomos shkencat nacionale, identitare dhe këto janë tri shtylla të çdo programi, kanë veçori. Nëse duam të bëjmë lëndë identitare shqiptare, e kemi (historia nacionale, letërsia, gjuha e tjera), ne jemi kryesorët që i planifikojmë ato, se s't'i planifikon kush, as si orë, as si sasi, as si mënyrë pune. Edhe shkencat shoqërore po ashtu, nuk ka tekste universale. Ka variacione dhe ato zgjidhen. Edhe autorët në Francë, edhe në Angli, varet çfarë tipi të mësimit bën, në cilën shkollë. Një tekst që është ideal për një tip shkolle, nuk është për tjetrën.

Provat e shkencave identitare ka njëzet vjet që shqiptarët kanë provuar t'i bëjnë, disa kanë mbërri, disa s'kanë mbërri, disa s'i duan, se s'e duan veç një tekst, duan alter-tekst, edhe te ne, edhe në Shqipëri. Po flas për dy qendrat e mëdha të dijes identitare shqipe, por edhe të tjerët i kanë këto.

Prandaj, unë vetëm insistova që ka probleme, janë permanente, të përhershme, të gjitha duhet të diskutohen, po jo në këtë pikë. Nëse nuk është zbatuar ligji, ju thoni "është një pikë që ligji nuk është zbatuar", dhe këtu është esenca për sot. Për interpelancë dhe për diskutim të fortë në Parlament, kur të doni, i kemi instrumentet që ta kërkojmë. Atëherë ne bisedojmë pastaj edhe për problemin social të arsimit, që e përmendi Vetoni më duket, kryesisht, se është e vërtetë, nëse është shkollë gjithëpërfshirëse e të ikin pesëdhjetëmijë nxënës me një eksplodim social, eh ai është arsimi, shoqëria, problemi social me arsimin. Është punë tjetër, ata s'ikin pse janë librat të këqij, as pse është sistemi i keq, nëse edhe atje është 5: 3, por është problemi i ikjeve sociale.

Kështu që, zoti kryesues, unë po ndaloj këtu, por ndjeva nevojë, meqë diskutimi është publik, meqë institucioni yt është nivel i lartë, meqë ekzistojnë Legjislativi që jemi ne dhe Ekzekutivi, ekzistojnë edhe normat e komunikimit. Kurrkush nuk mund t'i shkëpusë këto norma të komunikimit, aq më tepër nëse kemi kaq shumë motiv të bisedojmë për një lëmi tepër të rëndësishme - marrja e dijes dhe kushtet e marrjes së dijes nëpër shkolla, nga një dije e marrë në nivelin elementar ose parashkollor deri në shkallën e doktoratës.

Kështu që, për ta shkurtuar, unë mendoj që rekomandimet asnjërën kurrkush s'e kontestoi. Unë mendoj që Kuvendi është i gatshëm, ndërsa le të mbetet si mundësi e diskutimit me Qeverinë, alias ministrin e Arsimit, qoftë në njërën, qoftë në formën tjetër.

E kjo puna, u tha edhe këtu, e komunikimeve, se u prek, interesant, edhe puna e teksteve që marrin burime që janë të pasigurta, "wikipedia" dhe elementet qarkulluese publike, u përmend edhe një adresim për një problem tjetër ndërmjet dy deputetëve, se "të kam bërë të fala"... me këtë tip komunikimi. Unë për vete po ju them, për këto çështje që po bisedojmë sot, njerëzit janë të lirë të komunikojnë si të duan, me kë të duan, por nëse nuk bisedohet në nivel institucional, të gjitha të tjerat janë pak si "hobi". Për rekreacion luajnë futboll edhe ata që s'dinë, nganjëherë

harrojnë cili është goli i vet. Mirëpo, për këto probleme bisedohet, Qeveria këtu, ose ministri e Parlamenti këtu. Atëherë le të komunikohet, le të shpërndalet, por derisa s'është dialogu direkt, t'i çohen të fala nëpërmjet rrjeteve sociale dikujt se çfarë mendon për diçka, individualisht mund të bëjnë çfarë të duan, por institucionalisht, për mua është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, atëherë edhe këtë e lëmë për seancën e nesërme për ta votuar, me mundësinë siç u tha, nëse dëshiron dikush të vazhdojë diskutimin për këtë...

Zonja Tërmmkolli, keni diskutuar një herë, por nëse keni edhe diçka për të shtuar, se nga dy herë s'e kemi zanat të diskutojmë për të njëjtën çështje. Nëse është replikë, në rregull. Zonja Tërmmkolli dëshiron replikë.

MELIHATE TËRMKOLLI: Shumë shkurtimisht, vetëm dy fjalë!

Së pari, ne kërkuam të rregullohen disa çështje. Nëse dikujt i duket që cilësia e arsimit në Kosovë është krejt OK, atëherë është çështje e tij ose e saj, por unë mendoj që çështja e cilësisë së arsimit nuk është krejt OK. A është punë e ligjit, a s'është, aty mund të bisedojmë, por se ka probleme me cilësinë e arsimit në Kosovë, ka probleme. E tash, nëse dikush do ta marrë barrën e dikujt tjetër, ose ka qenë pjesë, ose është pjesë e krijimit të krejt sistemit të arsimit, është problem i tij, ose i saj. Nuk po dua të hyj as me emra, as me asgjë. Këto libra nuk janë krejt të mira, nuk thashë që janë krejt të këqija, për t'i gjuajtur, se po mësojnë nxënësit, por ka paqartësi aty. Dhe, jo vetëm paqartësi, por ka edhe pasaktësi të mëdha. Po edhe kështu, me këto pasaktësi, më mirë është t'i dërgojmë në Luginë, kur ministri jep garanci se do t'i dërgojë, e Serbia të gjitha librat i fut në Kosovë.

Ngadalë, nuk po bëjmë këtu fushatë, fushatë po bën tjetërkush. Kjo është një, e dyta, zoti kryesues, unë veç do të kërkoja një sqarim, krejt këta deputetë të PDK-së që kanë shkuar sot në fushatë pas Kadri Veselit, a kanë për të marrë mëditje, a jo?

KRYESUESI: Unë, sa i përket asaj çështjes së librave në Preshevë, mendoj se edhe ministri edhe ne duhet të jemi të kujdesshëm, dhe kur premtojmë e kur duam të veprojmë, duhet të analizohen mirë çështjet edhe me institucionet lokale dhe qendrore atje, e pastaj të marrim hapa.

E sa u përket mëditjeve, për nder, unë s'e kam ndërmend t'ia ndal kurrkujt mëditjen se s'mund t'ia ndal unë, kështu që më mirë është të mos them fjalë të mëdha.

Shaip, e kërkoje fjalën? Zoti Hamiti dëshiron të plotësojë diçka.

SABRI HAMITI: Faleminderit!

Unë po vazhdoj, kam shpjegim, interpretim të vogël. Është e vërtetë, emër s'u përmend dhe as unë s'po përmend emër, prandaj po e vazhdoj logjikën time.

Arsimi në Kosovë është sistemi më i madh që implikon rreth 1/4-tën e popullsisë së Kosovës. Edhe po të ishte i deklaruar ideal, është problemi më i madh i Kosovës, por nuk është ideal, prandaj gjithë shoqëria aktive është e implikuar në të, kështu që edhe po të investohej edhe para

tri herë nga këto që janë, se konsiderohet në çdo lëmi të Kosovës për një zhvillim mesatar na duhet buxhet trefish në secilën, në arsimin që themi se do ta kemi prioritet, i bie dyfish, ose 100% më shumë se në fushat tjera, prandaj duke filluar nga librat, te shkolla, te mësuesit, të cilët prodhohen si brez, jo si trening, ka probleme. Por, unë po them që nuk ka mundësi që të gjitha këto probleme të shqyrtohen në një raport të një zbatimi të një ligji, sepse edhe reformat bëhen me ligje, e unë thashë që është problem, është lëmi super e kushtëzuar.

Puna e dhënies së librave, në këtë rast tepër konkrete, për Luginën e Preshevës, që dikush po i thotë Kosova Lindore, kini kujdes, problemi është edhe politik, edhe teknik, edhe financiar. Kemi thënë jo financiar, se është vendosur, ne kemi biseduar gjithë ditën e lume, tjetrën herë, para një viti...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju lutem, edhe një minutë ia vazhdoni!

SABRI HAMITI: ...Duhet të dërgohen tekstet, por jo si e tha kryesuesi, edhe ministri herën tjetër, që s'e shpjegoi. Nuk ka dalë ta thotë të vërtetën, as ministri, se përse janë refuzuar ato. Janë tekste që janë parë. Çka nëse neve na vjen një tekst 'vice versa', të cilin ti nuk mund ta çosh vetë në shkollë? Pra, ajo që i thonë reciprocitet në shkollë, në tekste, ka gjalle të mëdha, nuk është një fjalë goje, kështu që kur të vijë ministri le të diskutohet qartë.

Dhe, e dyta, ne jemi më afër, ne jemi lidhur, ne kemi qenë me kontakte më të mëdha me Luginën, por sa për tekste njësoj e ka detyrim edhe Shqipëria, edhe pjesët tjera ku mësohet tekstet shqipe të dërgohen. Problemi është teksti, të dërgohet teksti i mirë, është shumë me rëndësi. A shkohet me reciprocitet, apo shkohet me ndërmarrësi private të qarkullimit të librave, këto janë dy pikëpyetje, që duhet t'i zgjidhë Qeveria. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Po e shqyrtojmë raportin, që është pika e katërmëdhjetë dhe e fundit. Pastaj, në seancën tjetër, siç e dini në orën dhjetë, i votojmë nesër.

14. Shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2014

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar raportin e performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2014 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj zotin Mustafa, kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për arsyetimin e raportit me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe kjo çështje është shumë e rëndësishme, sepse duhet ta prezantojë situatën në një segment tejet të rëndësishëm të ekonomisë, të shërbimeve dhe të jetës në Kosovë, siç janë ndërmarrjet publike. Prandaj, këtë debat duhet ta konsiderojmë shumë të rëndësishëm dhe, natyrisht, që unë

raportin nuk do ta arsyetoj, sepse raportin është dashur ndoshta ta prezantojë dhe arsyetojë ministri. Por, unë do t'i prezantoj mendimet e komisionit.

Ka qenë një qëndrim i komisionit që për shkak të situatës që ka qenë me zgjedhjet në vitin 2014 ka mbetur pa u shqyrtuar edhe raporti i vitit 2013, e pastaj edhe i vitit 2014, kështu që ky raport, në fakt, ka tentuar t'i përfshijë të dyja vitet. Mirëpo, nëse i shikoni arsyetimet që i keni, nëse e shikoni paragrafin e parë të arsyetimit, shihni që komisioni në tentimin e parë, kur e ka trajtuar këtë raport në janar të vitit 2016, ka kërkuar një mori plotësimesh nga Ministria për Zhvillim Ekonomik, përkatësisht njësia përkatëse që i monitoron këto ndërmarrje dhe në qoftë se një raport që duhet të flasë për performansën, kërkohen këto shënime që ne i kemi këtu në arsyetim të rekomandimeve tona, kjo vetvetiu tregon se ajo njësi duhet të punojë shumë më mirë, duhet të aftësohet shumë më mirë dhe të jetë e zonja që ta monitorojë performansën, sepse monitorimi i performansës së ndërmarrjeve publike është njëra nga çështjet më serioze edhe të këtij Kuvendi, edhe të Qeverisë së Kosovës.

Unë mendoj se këtu ka shumë gjëra që nuk janë në rregull dhe shumë gjëra që duhet të përmirësohen, prandaj ne ende tentojmë që ta vëmë në rend dite performansën dhe përgjegjësinë e bordeve. Ju lutem, ky Kuvend ka të bëjë me përgjegjësinë e bordeve dhe prandaj bordet duhet ta detyrojnë menaxhmentin që të jetë përgjegjës. Ne po i shqyrtojmë raportet prej viti në vit, në mënyrë deskriptive, por mund të them se në qoftë se një njësi nuk na i sjell ato elemente për ta vlerësuar përgjegjësinë e bordeve, edhe pas kërimit tonë që të plotësohet raporti, domethënë atje mungon një punë sistematike dhe mungojnë kapacitetet e duhura, sidomos prej se ka shkuar drejtori. Dihet, nuk dua të them, se tash ka ardhur një drejtor, një ushtruese e detyrës, por në përgjithësi ajo njësi, Qeveria duhet ta marrë shumë seriozisht dhe Ministria që ta aftësojë atë njësinë për vlerësimin e performansës, që ta kryejë detyrën e vet, sepse vija e përgjegjësisë së bordeve në ndërmarrjet publike nuk ekziston.

Për shembull, kemi ndërmarrje publike ku prej viti në vit bie puna, kurse pagat e punonjësve zvogëlohen, pagat e bordit dhe të menaxhmentin nuk zvogëlohen dhe ne s'kemi asgjë prej kësaj pune. Kërkojmë informata, thonë në raportin tjetër do t'i sjellim. Mendoj se çështja është shumë serioze dhe ne kemi përgjegjësi, prandaj pa marrë parasysh sa deputetë jemi sonte, pa marrë parasysh që ndoshta s'e kemi këtu ministrin e Zhvillimit, mendoj se ata duhet të jenë të informuar dhe duhet ta dinë se këtu duhet një punë shumë serioze.

Prandaj, më lejoni t'i arsyetoj rekomandimet, pa elaboruar më shumë. U tha që rekomandimet po i sjellim, por mendoj se në qoftë se rekomandimet e Kuvendit apo konkluzionet a vendimet e Kuvendit nuk zbatohen, atëherë nuk është fajtor vetëm Qeveria, është fajtor edhe ky Kuvend, sepse në qoftë se vetë Kuvendi nuk kujdeset për zbatimin e rekomandimeve të veta, atëherë unë s'di kush duhet të kujdeset. Natyrisht, Qeveria duhet të kujdeset, por trupi primar i cili duhet të kujdeset për zbatimin e rekomandimeve dhe nëse shkojnë në adresën e duhur rekomandimet, është Kuvendi.

1. Kërkohet që njësia përkatëse në Ministrinë e Zhvillimit dhe të Ekonomisë të avancojnë mënyrën e raportimit, strukturën dhe përmbajtjen e raportit vjetor të performansës së ndërmarrjeve publike sipas ligjit përkatës për ndërmarrjet publike.

Ju e dini që ne e kemi plotësuar ligjin pikërisht për ta ashpërsuar përgjegjësinë e bordeve lidhur me performansën, por ky raport nuk e ka ndjekur atë ligj.

2. Qeveria, përkatësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik të ndërmarrin masa për ngritjen e kapaciteteve të aftësisë së njësisë për monitorimin e ndërmarrjeve publike, që ajo të jetë në gjendje ta mbikëqyrë në mënyrë sistematike dhe të plotë performansën e këtyre ndërmarrjeve, përgjegjësinë e bordeve dhe trendët e zhvillimit të këtyre ndërmarrjeve.

3. Qeveria të ndërmarrë masa për të kërkuar transparencën dhe llogaridhënien, përkatësisht përgjegjësinë e bordeve. Ju lutem, Qeveria drejtpërdrejt i emëron bordet, ajo duhet t'i kontrollojë, natyrisht, edhe Kuvendi nëpërmjet Qeverisë.

Pra, duhet të kërkojmë përgjegjësinë e bordeve lidhur me zhvillimet. Kemi disa ndërmarrje që me vite u bie performansa. Suksesi financiar dhe përgjegjësinë e tyre për ta ruajtur, përkatësisht për ta rritur vlerën e aseteve të ndërmarrjeve publike, sipas Ligjit për ndërmarrjet publike.

Mendoj se janë pjekur kushtet që në disa ndërmarrje publike Qeveria duhet ta shqyrtojë përgjegjësinë e bordeve. Përderisa, Qeveria dhe ne këtu si Kuvend nuk kërkojmë përgjegjësi prej atyre bordeve, atëherë do ta kemi një vrapim nga të gjitha anët për të hyrë në borde, por në qoftë se kërkojmë përgjegjësinë e këtyre bordeve për gjendjen në ndërmarrje publike, atëherë njerëzit edhe do të mendojnë të shkojnë aty, sepse përgjegjësia është ligjore.

4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Auditori Gjeneral t'i përcaktojnë procedurat për auditimin e ndërmarrjeve publike. Komisioni propozon që Auditori Gjeneral ta marrë përgjegjësinë e auditimit të këtyre ndërmarrjeve publike dhe vlerësimin e performansës së bordeve dhe menaxhmentin të tyre. Gjithashtu, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Qeveria ta ashpërsojë përgjegjësinë për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit në ndërmarrjet publike.

Mendoj se ky rekomandim është në rrugë të mirë që të aprovohet në Ligjin për auditorin. Atje është një amendament, me të cilin Auditori i Përgjithshëm obligohet që të bëjë auditimin e ndërmarrjeve publike.

5. Rekomandimi i fundit ka të bëjë me kërkesën që raporti vijues t'i sqarojë në hollësi shkaqet e rënies së performansës së ndërmarrjeve publike, aty ku ka rënie, duke i trajtuar të gjithë parametrat që kanë ndikuar në këtë rënie dhe duke përcaktuar përgjegjësinë e bordit.

Këto janë rekomandime. Unë ju ftoj që t'i raportojmë. Komisioni ka menduar, meqenëse ka qenë vonë, 2014, 2013, ka menduar të mos i dërgojë fare në procedurë, por për shkak të nevojës që Kuvendi t'i ketë këto rekomandime, ne kemi propozuar që edhe raportin me këto rekomandime dhe plotësime që i kemi këtu të aprovohet, por më tepër për shkak të nevojës që këto rekomandime Kuvendi t'i dërgojë në drejtim të Qeverisë dhe ministrisë përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në radhë është deklarimi i grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së nuk është paraqitur askush. Në emër të Grupit Parlamentar janë tre të paraqitur. Kush e do fjalën në emër të grupit parlamentar? Zoti Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryesues!

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës është me interes të veçantë, jo vetëm tash, por gjithnjë, pra në vazhdimësi, performansa e ndërmarrjeve publike, prandaj edhe rekomandimet në fjalë, që u thanë nga kryetari dhe komisioni këtu, janë një punë e mirë, e cila do t'i shërbejë Qeverisë që në fazat e mëtejshme të ndërmarrë masa në përmirësimin e situatës në ndërmarrjet publike.

Vetë fakti që këto ndërmarrje publike e kanë një impakt të madh në jetën ekonomike të vendit, prandaj shikuar nga vlerësimet, opinionet, kritikën në faza të caktuara na japin shumë arsye që realisht t'i adresohemi Qeverisë në mënyrë që ta përmirësojë punën në këto ndërmarrje publike.

Pa dashur të humb shumë kohë, sepse edhe më herët është debatuar lidhur me performansën e ndërmarrjeve publike, unë mendoj po ashtu që një matës i mirë për punën e Qeverisë është edhe qeverisja e ndërmarrjeve publike. Pra, çdo bilanc kur bëhet për një qeveri, një pjesë e punës së Qeverisë duhet të matet se çfarë rezultatesh ka pasur në ndërmarrjet publike, sepse këto tash kanë një impakt të madh në krejt proceset politike, ekonomike, sociale dhe zhvillimore të vendit.

Prandaj, për Lidhjen Demokratike të Kosovës do të mbetet që Qeveria të ndërmarrë masa të tjera dhe me politikat e saj me prioritet të shohë përmirësimin dhe mënyrën se si ta kemi një performansë më të mirë të të gjitha ndërmarrjeve publike në vendin tonë. I mbetet pra Qeverisë që t'i zbatojë rekomandimet, por në të njëjtën kohë edhe të ndërmarrë politika të reja në përmirësimin e situatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Me gjithë mungesën e deputetëve, por edhe mospranim e Qeverisë tregon seriozitetin e problemeve, që de facto ne duhet të merremi me këtë pikë në një debat, por jo këto rekomandime të diskutohen, ose të aprovohen në këtë mënyrë.

Kur flitet për performansën nuk duhet përzier çështja e ndërmarrjeve publike si e veçuar, pa u folur edhe performansa e Qeverisë. Dhe, performansa e Qeverisë është në pikëpyetje sot në Republikën e Kosovës, sepse këtu sot për këto rekomandime, së paku është dashur të jetë ministri i Zhvillimit Ekonomik, ministri i Industrisë, ministri i Çështjeve Sociale dhe ministri i Financave. Pse e them këtë? Me gjithë respektin për kryetarin e komisionit, këtu është përdorur një lloj tautologjie, që shihet se jeni të interesuar vetëm të goditen bordet, mirëpo pa e thënë esencën e problemeve. Dhe, ato borde, siç thatë ju, Qeveria po i emëron, ndërsa Qeveria nuk po vjen të arsyetojë se sa ajo është duke i monitoruar bordet. Dhe, bordet, ne si deputetë, kemi të drejtë të përzihemi në problemet e ligjeve, ku janë duke u përzier. Dhe, radhitja e pikëve, rrjedhimisht pika e pestë ishte dashur të jetë pika e parë, mandej të bjerë më poshtë, e jo të përzihen disa tautologji. Pse e them këtë? Dje ishte një demonstratë këtu para Ministrisë së Çështjeve Sociale. A është Posta e Kosovës ndërmarrje publike dhe ndërmarrje që i takon Qeverisë dhe popullit të Kosovës dhe demonstroi kryesisht për të marrë shërbime nga Republika e Kosovës dhe Republika e Kosovës, Qeveria u jep pensionimet të shpërndahen nëpër bankat private për interesa të personave që janë aksionarë në bankë. Do të thotë me lidhjet politike që janë në atë bankë ua cakton dhe i humbë 300 mijë deri në gjysmë milioni euro në vit

dhe arsyeshmëria thuhet se Posta e Kosovës nuk ka siguri për t'i transportuar ose siguruar ato mjete. Dhe kjo, do të thotë, është ndërmarrje publike.

Po ashtu, ministri i Zhvillimit Ekonomik bën marrëveshje me IPKO-n për t'i shfrytëzuar shërbimet e tyre me telefoni mobile, ndërsa Vala është e Republikës së Kosovës dhe ne këtu për çudi kërkojmë nga bordet, t'u themi atyre se çka do të bëjnë. Ato s'kanë asgjë të bëjnë, sepse e dinë, qeveritarët i kanë emëruar, ne nuk po kërkojmë që të shihet cili ligj është shkelur. Është shkelur ligji 9.4 i prokurimit publik.

Ne këtë e kemi për detyrë dhe kush është përgjegjësi që e ka shkelur atë ligj. Do të thotë, ky është problemi.

Problemi tjetër është ndërmarrja publike - Korporata Elektroenergjetike e Kosovës, e cila sot prodhon korrent dhe i shpërndanë KEDS-it, KEDS-i kur është privatizuar, ajo e ka marrë përsipër që edhe borxhet e vjetra, edhe problemet e evitueshme të cilat janë në transmetimet teknike do t'i riparojë dhe për atë ka marrë një tender të favorshëm. Dhe në atë tender, sot KEDS-i dhe KEC po luan me konsumatorët e industrisë së vogël dhe industrisë së madhe.

Po e marr një shembull. Në Republikën e Kosovës, ekzistojnë tri industri që veprojnë. Është "Shar-Cem", është "Ferronikeli" dhe është "Trepça", të cilat janë shfrytëzues të mëdhenj të energjisë elektrike.

E dini ju si deputetë sa paguajnë korrent megavatin "Trepça", "Ferronikeli" dhe "Shar-Cem"? "Shar-Cem" dhe "Trepça" e paguajnë nga 29 euro megavatin, ndërsa "Ferronikeli", pas vizitës së kryeministrit nga 49 që e ka paguar megavatin, e paguan tash, që u kanë thënë nja 7% po ua ulim, është 45,7% ashtu diçka. Do të thotë afër euro më shumë se sa "Shar-Cem".

Sharceci e shet tërë produktin në Republikën e Kosovës dhe sot Feronikeli gjendet në Drenas, është e vetmja industri në atë regjion të Drenicës, e cila nëse i ka dërguar punëtorët në pushim nën emrin për ta rinovuar ose remontan e fabrikës, por informacionet janë sepse operatori është duke e parë rrugën të ikë nga Kosova, për shkak të sjelljes dhe mu për shkak të ligjit të diskriminimit, të konkurrencës dhe të mosrespektimit të ligjit, e që ne jemi përgjegjës.

Dhe, KEK-u si ndërmarrje publike sot, në muaj humbë 1 milionë e gjysmë euro profit, në shitjen vetëm në "Ferronikel" dhe në total në vit humbë shitje direkte mbi 55 milionë euro. Dhe këto vlera ne duhet t'i shohim në ekonomi, për të cilën ne po flasim, prandaj ne nuk mund të miratojmë, por ne duhet ta diskutojmë nesër me 4 ministrat që janë dhe me kryeministrin pa nervozë pse është një diferencë të tillë. Pse unë jam shqetësuar në këto farë varirime.

E njëjta kompani, siç është "Ferronikeli" në Maqedoni, të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë, paguan 33 euro megavatin e rrymës elektronike në FEN-i të Kavadarci, ndërsa ne ia faturojmë me 46, ndërsa "Shar-Cem" 29, "Trepça" 29. Këto janë fakte të cilat janë dokumentacion dhe duhet të arsyetohen pse bëhen, dhe nëse dalin 650 punëtorë nga puna në Drenicë dhe mbesin të pa punë, kjo nuk mund të garantojë zhvillim ekonomik ose nëse mbesin pa shërbime punëtorët e Postës dhe Korporata Elektroenergjetike, e cila ka probleme të jashtëzakonshme e humbë edhe këtë shitjen që e ka të vogël, ne nuk di për çfarë flasim.

Prandaj, performansa duhet t'i bëhet Qeverisë, duhet të shihen gabimet dhe jo të kërkohet që të merren problemet anësore, kur Qeveria nuk jep shërbime, nuk i monitoron ndërmarrjet publike në mënyrë direkte e indirekte që reflektojnë në ekonomi, unë nuk e di për çka jemi duke folur. Faleminderit zoti nënkryetar!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa, deshët replikë? E ka fjalën zoti Mustafa!

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit!

Sa i përket këtu tautologjisë, këtu s'ka kurrfarë tautologjie për arsye se aty ku duhet të thirret Qeveria thirret Qeveria, aty ku duhet të thirret bordi duhet thirrur bori dhe ne nuk jemi sot këtu ta amnistojmë askënd nga përgjegjësia.

Gjithashtu dëshiroj të theksoj sene po flasim këtu për Raportin e vitit 2013 dhe 2014. Natyrisht se kjo Qeveri, që është zgjedhur, duhet t'i marrë ato probleme që barten prej vitit në vit dhe t'i adresojë dhe këto rekomandime kërkojnë pikërisht këtë. Natyrisht se me këto rekomandime nuk mund të adresohen të gjitha privatizimet, të gjitha kontratat, të gjitha vendimet.

Ne do të kemi së shpejti për diskutim Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ku bëhet fjalë për rregullimin e çmimeve të energjisë dhe atje mund t'i diskutojmë këto çështje por jo këtu.

Unë besoj se problemi në "Ferronikël" shumë më shumë se sa problemi i çmimit të energjisë, është problemi i bursës dhe tregut botëror të çmimit të ferronikelit. Kjo, sa për ta sqaruar opinionin. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë, Shaip Muja, një minutë!

SHAIP MUJA: Profesor Mustafa, ekonomia e tregut dhe ato që i përmenda për çështje të ligjeve, ato janë duke u shkelur nga Qeveria dhe ne kemi për detyrë t'i monitorojmë ligjet.

Çështja e çmimeve është ZRRE, e cila duhet dhe arsyetohet se janë borxhet e vjetra, borxhet e këqija që nëpërmjet ekonomisë..., dhe ju mund të propozoni në fleksibilitet monitorimin sipas bursës.

Ka metoda të cilat ju i dini si monitorohen, meqë jeni ekonomistë.

Ndërsa sa i përket Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e njëjta kompani nuk e lejon minierën e vet ta shfrytëzojë dhe është në dijeni edhe kryeministri edhe Qeveria, nuk e lejon "Ferronikelin" ta marrë xehen e vet dhe kjo do të thotë se ose është duke u bërë një taktikë që në Drenicë të mbyllet e vetmja industri që ekziston, por mund të gaboni sepse mund të ketë reperkusione shumë interesante për zhvillimet shoqërore në Republikën e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Po flasim për një temë, e cila jo rrallë herë ka qenë pjesë e debatit parlamentar, qoftë përmes edhe pyetjeve parlamentare, qoftë edhe përmes diskutimeve individuale, por mbi të gjitha edhe përmes raporteve që janë shqyrtuar të këtyre organizatave buxhetore, edhe në aspektin që po e potencojmë të performansës, dhënies së përgjegjësisë, llogaridhënies dhe shpenzimit të parasë publike.

Unë mendoj se ky raport nuk i plotëson kushtet dhe kriteret që sot të miratohet. Këtë pak a shumë edhe komisioni e ka arsyetuar në vendimin e vet, mbi të gjitha, kur ka kërkuar edhe informacione shtesë për çështjet të cilat shumë herë kanë qenë pjesë e këtyre debateve dhe kanë qenë pjesë edhe e shqetësimeve të institucioneve, qoftë këto të Kuvendit të Republikës së Kosovës e të deputetëve, por mbi të gjitha edhe të medie dhe shoqërisë civile.

Pjesa e aspektit në të cilin pasqyrohet puna e këtyre bordeve, që ndërlidhet shumë me menaxhmentet aktuale, tregon qartë se në këto institucione ne kemi diskrepancë, qoftë në menaxhimin e parasë, qoftë të hyrave, qoftë të aseteve dhe mbi të gjitha çdoherë auditori gjeneral ka dhënë vërejtje e rekomandime të cilat nuk janë përcjellë dhe të cilat shihen thjesht se edhe komisioni i ka evidentuar, por pak a shumë ka lejuar që me një informacion plotësues të dobishëm, por edhe me një konstatim tjetër që thotë - prapë mbetet i pakompletuar.

Andaj, unë mendoj se duhet një analizë shumë më e thellë, edhe sot kur po bisedojmë pa njerëzit kompetentë këtu që të japin përgjigje dhe përgjegjësi, mendoj se kjo çështje është shumë më e rëndësishme se sa vetëm të kalohet në këtë formë. Pse? Sepse edhe sot e kësaj dite nuk ka mund të kontrollojë apo, të them, të saktësojë edhe në mënyrë ligjore, mbi të gjitha të rekomandojë dhe të japë dikush llogari për këto bonuse të menaxhmentit dhe të bordeve që kanë shpenzuar nga kjo e hyrë, sidomos pjesa kur flitet çdoherë në të gjitha këto ndërmarrje publike, është treguar qartë në performansën e tyre se kanë pasur, ta quaj rënie, e ndërsa bonuset, pagat në shumicën e tyre kanë pasur rritje, përjashtimisht në disa ndërmarrje që shpeshherë marrim informacione e kërkesa që punëtorët e thjeshtë ballafaqohen me mungesë të pagave me muaj të tërë, ndërsa bordet dhe menaxhmentet asnjëherë nuk janë ankuar për këtë pjesë, apo për këtë shumë e cila inkasohet në mënyrë të padrejtë.

Vetëm të shikohet një ndër faqet e këtij raporti për pagat mesatare mujore që i arkëtojnë njerëzit në këto ndërmarrje publike. Pothuajse më e ulëta është dyfishi i pagës mesatare që është në Republikën e Kosovës.

S'po flas për shifrat tjera, se janë marramendëse dhe mund të keqintpretohen por edhe të merren në aspektin individual. Por ne kemi pagë deri diku që te këta mbërrin edhe mbi 4 500 euro pagë mujore. Dhe kjo tregon seriozitetin e monitorimit apo njësisë së monitorimit të ndërmarrjeve publike në vend.

Mbi të gjitha, duhet të tregojë edhe seriozitetin tonë si Kuvend i Republikës së Kosovës, andaj unë mendoj që ky raport duhet t'i kthehet dhe plotësohet me pika që ka kërkuar konkretisht Komisioni, sidomos në pjesën ku kemi të bëjmë me aspektin e përgjegjësisë, pasqyrat e afarizmit financiar, shpenzimet për paga e mëdijtje për udhëtime, shpenzimet për bonuset e menaxhmentit dhe bordit, konstatimet e auditorit, rekomandimet që janë përcjell nga viti në vit mund t'i shtohet dhe tek atëherë të nxjerrim konkluzione nëse duhet të përkrahet një raport i tillë apo jo.

Unë mendoj që nëse vazhdojmë kështu do të jetë një avaz i njëjtë edhe për bordet e reja, edhe për emërimet e reja, sepse do ta gjejë një gjendje të njëjtë, do ta gjejë një praktikë të njëjtë të shfrytëzimit të këtyre bonuseve dhe këtyre pagave, ndërsa avancimi i zhvillimit ekonomik do të ngecë në shumë fusha pa dashtë të hy në aspektin apo në karakteristikat individuale që kanë këto ndërmarrja publike. Dhe, mbi të gjitha, tashmë është krijuar edhe si refren i qartë, kërkesa e llogaridhënies mbetet vetëm në trajtimin e këtij raporti, por vetëm kur kemi ndërhyrje të ndonjë mediumi apo vetëm kur kemi ndërhyrje dhe ato shumë të rralla të organeve të sigurisë në aferat korruptive neve na del gjumi e të shohim se çka po ndodhë me ato ndërmarrje publike.

Prandaj, po mendoj se Komisioni i ka saktësuar, i ka konstatuar dhe mbi të gjitha në fund të fundit ka rekomanduar që ky raport të shkojë dhe marrë votën pozitive që, për mendimin tim, nuk duhet të shkojë në këtë formë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Gëzim Kelmendi!

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryesues!

Duke parë rrjedhën e debatit, padyshim se edhe shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike, konkretisht gjendja në ndërmarrjet publike kërkon një debat më të gjerë parlamentar, jo vetëm me një raport, në të cilin Kuvendi i Kosovës faktikisht nuk ka kurrfarë qasjeje të drejtpërdrejtë. Do të thotë, Kuvendit i duhet të miratojë një raport që është ardhur me shkrim dhe ta miratojë e kalojë.

Prandaj, edhe unë pajtohem që ky raport duhet të kthehet prapa dhe në anën tjetër duhet të organizohet një debat i mirëfilltë në Parlamentin e Kosovës për gjendjen dhe konkretisht për performansën e ndërmarrjeve publike nga se ne e dimë pa barazinë që është shkaktuar në vite në këtë sistem ku shumica e udhëheqjes, e menaxhmetit udhëheqës ka përfutur shuma marramendëse, ndërsa punëtorët tjerë kanë mbetur viktimë e kësaj udhëheqje.

Prandaj duke parë rëndësinë e kësaj, mendoj se Kuvendi duhet të ketë qasje të drejtpërdrejtë, nuk duhet të marrë vetë diçka me shkrim e të miratojë, por megjithatë të organizojë një debat parlamentar.

Ajo tjetra, pa dashur të zgjas më shumë, nga se po e shohim edhe seriozitetin e seancës - nuk kemi deputetë fare këtu në seancë, përveç një pakice të vogël të deputetëve, unë mendoj se nuk është mirë që seanca vetëm për këto tri raporte që i lexuam sot të vazhdojë nesër për dy arsye të mëdha, kryesues, e para do ta mashtrojmë opinionin publik me shtyrjen për të nesërmen, ngase asnjëra nga këto tri raporte që u lexuan sot nuk kanë ndonjë urgjencë të veçantë, apo nuk janë pjesë e pakos së liberalizimit të vizave dhe do ta mashtrojmë opinionin se kinse Kuvendi i Kosovës i ka mbajtur dy seanca brenda këtij muaji prill, e në fakt nuk ka nevojë dhe e dyta t'u ikim shpenzimeve të panevojshme.

Këto tri raporte mund të jenë vetëm nga një seancë të radhës kur do të mbahen seancat e rregullta, do të votohen me procedurë të rregullt, e jo të organizojmë seancë të veçantë nesër për ta mbuluar performansën negative që e ka pasur kohë të gjatë Kuvendi i Kosovës.

Prandaj, ideja që të shtyhet për nesër, unë mendoj se nuk është e qëlluar, por të vazhdojmë në një seancë të rregullt, të votohen në një seancë të rregullt, nga se nuk kanë asnjëri nga këto raporte urgjencë të veçantë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Faleminderit për fjalën! Do të mundohem të mos e zgjas. E para, sigurisht edhe mua sikur edhe shumë deputetëve, fare s'më pëlqen që s'është prezent asnjë ministër këtu. Por, për të thënë pse s'janë ata, po ashtu, s'më pëlqen fare dhe nuk ka justifikim pse po mungojnë deputetët. Sepse, fundi i fundit, ne në fund duhet të votojmë ose i votojmë ose s'i votojmë, por ne i votojmë dhe konsideroj që kjo nuk duhet të ndodhë dhe aq më tepër për tema që janë të një rëndësie të veçantë. Çdoherë temat në Kuvendin e Kosovës, besoj e kanë rëndësinë e caktuar, por janë disa të cilat vërtet prezencja e atyre që duhet të dhënë përgjigje, edhe atyre që duhet të bëjnë pyetje, duhet të jenë prezent edhe njëra e edhe pala tjetër. Ndërkaq, ne s'po na ndodh sot, të them, as njëra e as tjetra.

U përmendën shumë çështje, edhe në pikën paraprake. Unë jam i bindur që s'ka temë tabu që s'duhet të diskutohet në Kuvend. Fundi i fundit, për këtë edhe jemi të autorizuar, për këtë edhe jemi deputetë edhe për gjendjen në arsim, edhe për gjendjen në shëndetësi, edhe për gjendjen në ndërmarrjet tona publike, edhe për çmimin që tash po flitet, sepse kjo puna e çmimeve që u përmend më herët nuk është e sotme. Duhet të shihet a është ligjore pse në një ndërmarrje është ky çmim, në tjetrën është tjetër çmim. Dhe mund të jetë, sepse njëra është kompani private, ose është e privatizuar, e tjetra është publike, sikur që po flasim dhe normalisht që mund të ketë edhe ndonjë dallim. Por, nëse është dallimi, duhet ditur a është i ligjshëm a jo. Nëse nuk është i ligjshëm, pse është ky dallim dhe të gjitha këto janë tema ose pika që nuk kanë lindur sot si probleme, por mund t'i bisedojmë kur të jenë të pranishëm ata që duhet të dhënë edhe përgjigje në të gjitha ato që i shtrojnë deputetët si shqetësim.

Do të thotë, më shumë e mora fjalën të them se, sinqerisht, ne duhet të angazhohemi që të jemi prezentë dhe duhet të kuptojmë situatat e caktuara që ndonjë deputet mund të mungojë, por kjo nuk na amnistion të gjithëve që të mungojnë me shumicë në mënyrë që të mos marrim vendime dhe kjo, e para, është përgjegjësi jona si deputetë, e pastaj është edhe përgjegjësia e ministrave të resorëve përkatës, aq më tepër kur janë pikat e caktuara që kanë të bëjnë me fushëveprimtarinë e tyre. Ne sigurisht në të ardhmen do të bëjmë përpjekje dhe duhet të bëjmë përpjekje t'i koordinojmë këto më mirë, sepse më mirë është fare të mos mbahet seanca e të debatojmë, mos të them kot, sepse fundi i fundit çdo debat e ka rëndësinë, por kur nuk mund të marrim vendime atëherë kjo vërtet e humbë peshën e rëndësisë së mbajtjes së seancës dhe marrjes së vendimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë po e përsëris, nesër i kemi 6 pika të rendit të ditës dhe 3 votime që do të mbeten nga sot, kështu që nuk e kemi sa për t'i votuar 3 raportet. Fjalën e ka zoti Grainca.

BLERIM GRAINCA: Zoti kryesues!

Të nderuar kolegë!

Vërtet s'e pata në plan të flas, por kur e pashë se edhe Ismeti foli për ndërmarrjet publike, atëherë u desh patjetër ta marrë fjalën. Kjo për Ismetin ishte metaforë, besoj se e kuptuat.

Më lejoni t'i sqaroj dy gjëra. E para, ky raport ka ardhur me vonesë në Komisionin për Zhvillim Ekonomik dhe i referohet periudhës së vitit 2013-2014. Nëse dëshirojmë që fajin t'ia adresojmë Qeverisë atëherë duhet thënë se kjo Qeveri, me sa unë kujtoj, e ka dhënë betimin në dhjetor 2014, pra në fund të vitit dhe nuk i adresohen këto probleme kësaj Qeverie.

Nuk jam këtu për të amnistuar Qeverinë, sepse mungesa e saj nuk amnistohet me kurrgjë, por jam këtu për t'i thënë dy-tri çështje. E para, ne po flasim për rekomandimet që kanë ardhur si rezultat i shkeljes në kompanitë publike. Pra, po miratojmë rekomandime me qëllim që të përmirësohet performansa e kompanive publike. Dhe, të gjithë po pajtohemi se ajo performansë nuk ka qenë në rregull dhe nuk është në rregull as sot e kësaj dite. Nuk kanë qenë në rregull, sepse shifrat flasin për rënie të vlerës së aseteve të këtyre kompanive. Dhe nëse një kompanie publike i bie vlera e aseteve, por rriten bonuset e menaxhmentit, bie performansa e bordeve, dhe rriten pagat, atëherë ky raport nuk duhet të votohet. Është fjala për raportin për kompanitë publike, por jo për rekomandimet. Sepse rekomandimet vijnë për të përmirësuar raportin që ka të bëjë me kompanitë publike.

Janë tri-katër çështje që u përmendën këtu e që mendoj se janë vetëm një pikë e vogël e performansës së këtyre kompanive publike.

Nëse flasim për bordet, atëherë duhet parë se çka kanë bërë ato borde për të ruajt vlerën totale të kompanisë. Për shembull kompanitë kryesore në Kosovë, kompanitë publike, kanë rënie të vlerës së aseteve dhe kjo nuk mund t'i adresohet Qeverisë aktuale. Këtë Qeveri mund do ta akuzojmë në vitin e ardhshëm kur të flasim për raportin 2015, nëse s'ka bërë kurrgjë.

Prandaj, duhet të jemi të matur kur japim kritika e adresime të tilla.

Nëse flasim për kompanitë publike, atëherë duhet ta kemi të qartë edhe tjetrën. Kompanitë kryesore publike, për shembull KEK-u, nuk ka regjistër të pronave të tij, të aseteve kryesore.

(Ndërhyrje)

Regjistër të aseteve të KEK-ut! Jo, zotërinj! Lexojeni raportin që e keni bashkë, e keni raportin e Auditorit të Pavarur, i cili konstaton se në KEK nuk ka regjistër të aseteve të KEK-ut. Por jo KEK-u, se nuk është bordi, menaxhmenti...

(Ndërhyrje)

Po, pra, në cilin vit, kush e ka zgjedhur atë bord? Unë ju kuptoj... Por, zoti Muja unë po gëzohem që jeni bërë edhe ekspert i ekonomisë.

(Ndërhyrje)

Jo, doktor i llojit tuaj, s'kisha dashur! Prandaj, më lejoni ta përfundoj këtë që desha ta them. Performansa e kompanive publike 2013/2014 ka qenë negative. Këto borde, përveç rënies së vlerës së aseteve duhet të japin përgjegjësi edhe për shitjen e pajisjeve, shitjen e makinerisë së disa kompanive që kanë bërë pa procedura dhe pa gjëra të tilla dhe dihet kush kanë qenë blerësit, prandaj unë ju ftoj që t'i miratojmë rekomandimet sepse rekomandimet kanë të bëjnë me përmirësimin e situatës, e nuk kanë të bëjnë me periudhën 2013 dhe 2014 apo me këtë Qeveri. Faleminderit!

KRYESUESI: Po, zoti Muja, replikë për vetëm 2 minuta!

SHAIPI MUJA: Unë nuk i di metaforat. Unë di direkt të flas. Një diçka është se nuk po flasim këtu që të marrim diçka në përgjegjësi të dënueshme, por të përmirësueshme.

Në 2014, kolegë i nderuar, qytetarët e Kosovës kanë pasur kolaps politik dhe ekonomik për shkak të veprimeve të papërgjegjshme të lidershipit, të krejt lidershipit, përfshirë edhe lidershipin e partisë tënde, dhe është quajtur VLAN.

Ndërsa sot, po flasim, nëse domi ne të përmirësojmë sot çfarë po ndodhë. Sot ke problem kur të mbyllet "Ferronikeli", sot ke problem kolapsin energjetik të Kosovës, sot ke probleme me të cilat ne duhet të merremi në debat dhe atë debat duhet ta thërrisni ju si komision, por jo ta politizoni.

Nuk ka nevojë të politizohet. Unë dje e kam parë demonstratën dhe nëse shkruhet, unë e kam raportin, që Posta e Kosovës i humb afro 500 mijë euro shërbime dhe i paguan tek banka, ministria i paguan 500 mijë euro dhe neni 9,4 i prokurimit publik, që e dini ju, ka shkelje dhe ka anakronizma.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është tek ne, ne jemi përgjegjës dhe ne, për shembull nuk e thërrasim e t'i themi - pse ti zotëri nuk ia jep privatit minierën e vet që e ka? Nuk i jep hapësirë, mundësi, sepse ata qytetarë marrin rrogë. Ne po shkojmë po promovojmë shkollën dhe në shkollën ku duhet të shkojnë fëmijët po ua nxjerrim prindërit nga puna. Ata s'kanë parë t'i çojnë në shkollë, dhe po flasim për edukimin këtu që po i kërkojmë dhe nuk po u kërkojmë mënyra tjera.

Prandaj, mos i politizo sendet por ta bëjmë ne një debat nesër për performansën e Qeverisë, për sjelljet e Qeverisë në industri, në energjetikë dhe në zhvillimin ekonomik, por jo t'i anashkalojmë... Ne s'po e thërrasim Qeverinë në votëbesim, t'u japim votën të funksionojë ajo apo jo.

Mirëpo, ne duhet të kritikojmë ku po shkelet ligji. Qeveria është duke e shkelur ligjin dhe ministrat janë duke i shkelur. Ministri i yt ose i joni, është. Ata janë ministra me një shef. Nëse shefi nuk i kontrollon ministrat është mirë me e lënë Qeverinë.

KRYESUESI: Faleminderit! E drejta për ta ftuar në interpelancë dhe në debat ministrin është përcaktuar me Rregulloren. Kur të doni mund t'i thërrisni, edhe ata duhet të vinë, se e kanë obligim. Prandaj, nuk ka nevojë t'i thërrasim përmes foltores, bëni shkresa, dorëzoni në protokoll të Kuvendit dhe gjithçka do të jetë në rregull. Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Unë mendoj që, megjithatë, është mirë që debatuar për arsye se po shihet që ka probleme, por unë nuk po e kuptoj ku është problemi i disa deputetëve.

Ne këtu jemi duke e trajtuar një raport - performansa e ndërmarrjeve publike. “Ferronikeli” nuk është ndërmarrje publike dhe shumëçka që sot u përmend në diskutim s’ka të bëjë me ndërmarrje publike.

Ne kemi thënë se kjo performansë nuk është e kënaqshme dhe nuk është prezantuar mirë në raport. Kemi rekomanduar që pikërisht kjo Qeveri të rrisë përgjegjësinë, në raportin e vitit 2015 të prezantohet më mirë në këto gjëra dhe të merren në përgjegjësi ata që nuk e zbatojnë ligjin.

Nuk di pse sot hapim tema, ose nëse ka dikush problem me këto rekomandime, le të thotë se ka problem. Por, jo të hapë kushedi sa probleme tjera që me e humb thelbin e debatit për çka jemi sot këtu.

Thelbi i debatit është shumë i qartë në këto rekomandime. Dhe në qoftë se dikush ka problem dhe ne të kërkojmë përgjegjësi për performansë ajo është tjetër punë. Ajo është tjetër punë! Prandaj, ju lutem dhe ftoj deputetët sepse sonte s’mundemi, por nesër t’i aprovojmë këto rekomandime sepse këto rekomandime do të kontribuojnë që të punohet më mirë edhe në Qeveri, edhe në borde dhe gjithkund. Shpresoj se duhet të kontribuojnë! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Grainca për kundër-replikë!

BLERIM GRAINCA: Vërtet nuk po dua të zgjas për këtë, por po dalim prej temës dhe nëse në raport thuhet qartë - raport me rekomandime, për raportin e ndërmarrjeve publike, atëherë cila është logjika të flasim për “Ferronikelin” që nuk është ndërmarrje publike.

(Ndërrhyrje)

A po doni të flisni për diçka tjetër, apo po doni të flisni për raportin? Mos t’i ngatërrojmë gjërat dhe mos të bëjmë këtu se është abc elementare e ekonomisë a jo?

KRYESUESI: Zoti Grainca, nganjëherë deputetët i keqpërdorin foltoret dhe s’ka dert për këtë shumë. Për nga pak, s’ka dert!

Atëherë, nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim. Mendoj se për sot e përfunduar dhe nesër në orën 10:00 do të vazhdojmë me 6 pika të mbetura dhe me votimet që s’i kemi bërë sot.

* * *

E premte, 29 prill 2016
Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 28 prill
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë,
Jemi para një situatë, më tepër është sensibilizuese këtë çfarë dua ta them. Ne partnerët e koalicionit duhet rishikuar nëse i janë bashkangjitur opozitës gjithë këta deputetë, i kemi 46-47 deputetë vetëm në sallë.

Partia Demokratike e Kosovës i ka 19 nga 35, Lidhja Demokratike e Kosovës i ka 20 nga 33. Minoritetet joserbe 7 nga 10, Lista serbe asnjë, 2 pa grup janë këtu dhe opozita nuk është këtu.

Unë ju numëroj në bazë të asaj që e kam marrë prej Administratës. Kujtim, urdhëro, ta shfrytëzojmë këtë kohë pa filluar seanca. E bëjmë një pauzë, ose presim edhe një herë edhe 10 minuta, por shefat e grupeve parlamentare... Nuk kam të drejtë! Urdhëro Profesor, se unë disa herë kam biseduar çka të veprojmë si konsultim. Vetëm konsultim, bisedë e lirë.

SABRI HAMITI: Kjo është temë e cila nuk shtrohet në Kuvend se s'ka si të shtrohet, por po shihet që grupet, ju zoti kryetar e drejtoni njërin prej partive më të mëdha në Kuvend. E zgjidhni ju çdo kryetar partie, tjetri është kryetari i partisë, është kryetari i Qeverisë së Kosovës nëpërmjet jush direkt dhe përmes shefit të grupit të juaj parlamentar. Kryeministri direkt dhe nëpërmjet shefit të grupit parlamentar i bëjnë këto punë. Kuvendi nuk ka çka të flasë se është i ndërtuar prej partive dhe prej individëve. Kështu që unë do të thosha që s'ka pse jepet pushim, s'ka arsye të jepet pushim, por ka arsye që njerëzit që i krijojnë grupet t'i thërrasin njerëzit.

KRYETARI: Po fillojmë, po e ndërrojmë pak veten nga vendimi i djeshëm, po futemi në deklarime jashtë rendit të ditës.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre 3 minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën. Urdhëro, zonja Lama!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Po e marr fjalën për t'i ngrehur dy probleme themelore që kanë të bëjnë me shtetësinë e Kosovës.

I pari ka të bëjë me një problem që kaloi gati në heshtje këto ditë kjo, sepse si duket është kthyer në normalitet një gjë që vetëm normale nuk është, e që është zhvillimi i zgjedhjeve të një shteti tjetër në territorin e Kosovës.

Këtë fundjavë u përsërit skenari që po zhvillohet prej 15 vjetësh në Kosovë mbajtja e zgjedhjeve serbe edhe pse Kosova është shkëputur më '99-tën nga Serbia edhe pse Kosova ka shpallur shtetin e pavarur më 2008. Zgjedhjet u zhvilluan me ndërmjetësimin dhe ndihmën e OSBE-së.

Kjo organizatë ndërkombëtare dhe unë kam sot shumë vërejtje për këtë si duket duke mos e ditur se me çfarë të merret tjetër në Kosovë në vazhdimësi është bërë një mbajtëse e dhunimit të sovranitetit të shtetit të Kosovës pasi lejimi i zhvillimit të zgjedhjeve të një shtetit tjetër nuk mund të jetë tjetër veçse diçka e tillë ose më keq kjo që po ndodhë është instalim dhe legjitimim i logjikës së sovranitetit të dyfishtë.

E kuptoj që Qeveria e Kosovës nuk dëshiron të përplaset me këtë organizatë, mirëpo kjo nuk mund të më ndalon mua si deputete dhe përfaqësuese e popullit të ngre disa pyetje themelore si:

Duke qenë se OSBE-ja përbëhet nga shtete anëtare dhe përfaqëson interesat e tyre, a ka ndonjë shtet në gjirin e saj që e lejon një praktikë të tillë siç është zhvillimi i zgjedhjeve të një shteti tjetër brenda një shteti të dhënë?

A do ta konsideroni shkelje sovraniteti secili prej këtyre shteteve një veprim të tillë? A do të pranonte Serbi që një shtet tjetër të zhvillonte zgjedhje brenda territorit të saj, ta zëmë Hungaria në Vojvodinë. A do të lejonte Serbia që OSBE-ja të barte materialin zgjedhor të një shteti tjetër e monitoronte kutit e votimit në territorin e saj për llogari të një shteti tjetër. Dhe lista e pyetjeve mund të vazhdoj besoj se përgjigjen e dini në secilën prej këtyre pyetjeve, është kjo? Atëherë pse OSB-ja në Kosovë punon në shpërputhje në praktikën dhe parimet e vetë shteteve të saj anëtare.

Misioni i OSBE-së në Kosovë është demokratizimi, mirëpo unë nuk po e shoh të realizuar këtë mision por po shoh një organizatë e cila pa mohuar kontributin e saj të mëparshëm aktualisht është kthyer në infrastrukturë të shtetit të Serbisë në Kosovë.

Serbët edhe mund të zhvillojnë zgjedhje në Kosovë, t'i organizojnë vetë dhe unë këtu nuk po bëjë ndonjë thirrje që të shkohet e të ndalohet me dhunë ky proces. Mirëpo fakti që OSBE-ja i mbështet do të thotë se e legjitimon këtë proces, e ky legjitimim bie në kundërshtim me interesat e shtetit të Kosovës të cilin OSBE si organizatë nuk e njeh mirëpo gjendet këtu me lejen e këtij shteti.

Prandaj, i bëj thirrje Qeverisë që ta shqyrtojë këtë problem, në mënyrë që praktika...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Mos ia ndal fjalën askujt, të lutem regjia!

ALMA LAMA: ...të tilla në të ardhmen të mos përsëriten. Po kështu nuk e shoh të arsyeshme që Policia e Kosovës është kujdesur për zgjedhjet e paligjshme që Serbia zhvilloj në Kosovë. Policisë i takon ta ruajë rendin, mirëpo nuk ka pse të vihet në shërbim të një procesi të paligjshëm.

Çështja e dytë dhe më aktuale për të cilën dua të flas lidhet me një zhvillim të djeshëm kur Unioni i Transmetuesve Evropian IBU ku bën pjesë edhe Radiotelevizioni i Kosovës e ka nxjerrë një rregullore për përdorimin e flamujve në festivalin e këngës Evropian.

Sipas kësaj rregulloreje, flamuri i Kosovës bën pjesë në listën e flamujve të ndaluar për tu mbajtur apo shfaqur në publik krahas disa flamujve të disa vendeve që nuk janë shtetas si për shembull Nagorno Karabahu, Krimea, Rajoni Bask e të tjerë.

Mirëpo, ajo çfarë bie në sy është se në listën e flamujve të ndaluar bënë pjesë edhe flamuri i një organizate terroriste siç është ajo e shtetit islamik të njohur me emrin ISIS dhe unë këtu e kam printuar që ta shihni.

Klasifikimi i flamurit të shtetit të Kosovës në një rang me flamurin e një vendi terrorist është fyerje e ndjenjave të milionave shqiptarëve kudo në botë dhe do të duhej të ishte fyerje e ndjenjave të të gjithë evropianëve.

Unë mendoj se kjo i tejkalon përmasat e një gafe politike, kjo tashmë është një çështje që duhet të ngrihet para gjykatave kompetente evropiane dhe duke qenë se qytetarët e Kosovës nuk kanë të drejtë të padisin në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, unë nga foltorja e Kuvendit do t'u bëjë thirrje shtetasve shqiptarë por që kanë edhe shtetësi të vendeve të tjera që ta bëjnë një padi të tillë.

Flamuri i Kosovës nuk mund të renditet as krahas flamujve të tjerë që përmenda më sipër të cilët IBU në Rregulloren e saj i klasifikon si flamuj të territoreve të shkëputura të krahinave, rajoneve apo të provincave që nuk janë anëtare të OKB-së. flamuri i Kosovës madje është renditur në krye të kësaj liste edhe pse Kosova është e njohur nga pjesa më e madhe e vendeve të Bashkimit Evropian 23 nga 28 dhe nga më shumë se gjysma e vendeve të OKB-së edhe pse pavarësia e saj është legjitimuar nga vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare, që gjithashtu është institucion i OKB-së.

IBI-u nga ana tjetër çdo vit përfiton mbi 300 mijë euro nga Radiotelevizioni i Kosovës i cili financohet nga taksapaguesit e Kosovës dhe unë këtë e shoh si keqpërdorim i drejtpërdrejtë i parave dhe dinjitetit të shtetit tonë.

Prandaj, i bëj thirrje Kuvendit që të reagojë fuqishëm ndaj kësaj fyerjeje për të cilën mbarë opinioni evropian dhe më gjerë ishte njoftuar sepse bëhet fjalë për një aktivitet mjaft të popullarizuar.

Gjithashtu kërkoj nga Ministria e Jashtme reagim të shpejtë siç kanë bërë entitetet e tjera që i përmenda më lart, të cilët madje as nuk janë shtete. Pasi unë prapa gjithë kësaj shoh lobimin e shtetit serb.

Po kështu, RTK-ja duhet t'i rishqyrtojë raportet e saj me IBIU-në pas klasifikimit të papranueshëm që i bëhet flamurit të shtetit të Kosovës, e që është ai me atë të një organizate terroriste. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, Raif Qela e ka fjalën edhe të përgatitet deputetja pa grup parlamentar Margarita Kadriu-Ukelli.

RAIF QELA: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
I nderuar kryetar i Kuvendit,
Ministra të pranishëm,
Kanë kaluar më shumë se 16 vjet që kur se pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës është spastruar etnikisht nga banda kriminale të udhëhequra nga ideologji shoviniste serbomadhe.

Kanë kaluar 16 vjet që kur mbi 12 mijë banorë të pjesës veriore të qytetit të Mitrovicës enden si qiraxhinj në pjesën jugore të Mitrovicës, në qytete të tjera të Kosovës dhe anekënd botës.

Institucionet e Kosovës nuk kanë bërë pothuajse asgjë për këta qytetarë, është fat i keq që është kështu, por kjo është e vërteta.

Përderisa qytetarëve shqiptarë nuk u lejohet kthimi në pronat e veta, përderisa qytetarëve shqiptarë nuk u lejohet të ndërtojnë shtëpi mbi themelet e shtëpive të djegura dhe të shkatërruar nga lufta, Serbia zyrtare investon dhe ndërton në krejt pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, sidomos është e pranishme në lagjet në të cilat kanë qenë ose janë akoma të banuara vetëm me shqiptarë.

Sa për ilustrim, në Lagjen e Boshnjakëve janë ndërtuar gjashtë ndërtesa 7-katëshe në Lagjen e Doktorëve një objekt 7-katësh, në lagjen Kroj i Vitakut 8 objekte 4-katëshe, në Suhadoll të Epërm është ndërtuar një objekt 6-katësh, në lagjen Kodra e Minatorëve janë ndërtuar dhjetë objekte 7, 8 dhe 10-katëshe. Në atë pjesë të qytetit vazhdon ndërtimi i objekteve të larta për serbët e ardhur nga të gjitha pjesët e ish-Jugosllavisë. Ky është kolonizim klasik. Përderisa në njërin anë kolonizohet një pjesë e qytetit nuk u lejohet pronarëve të ligjshëm, qytetarëve të atij qyteti të kthehen në pronat e veta. Çka duhet të bëjnë institucionet e Kosovës?!

Pa dyshim se duhet ta zbatojnë rendin dhe ligjin. Cili është ai ligj i cili lejon që në njërin anë të ndërtohen koloni, e në anën tjetër të mos lejojë qytetarët të kthehen në pronat e veta. Ligj i tillë është vetëm ligji i aparteidit. Ne i kemi ligjet tona, i kemi institucionet tona, por ato duhet të jenë më të përgjegjshme, institucionet tona të gjitha pa dallim, në veçanti kryeministri duhet në bashkërendim të plotë me faktorët ndërkombëtarë të gjejë mekanizma që qytetarët shqiptarë t'i kthejë në pronat e veta. Janë rreth 400 shtëpi të djegura që nuk po lejohen të ndërtohen, janë rreth 400 banesa, të cilat akoma nuk janë shitur e të cilat janë të uzurpuara dhe pronarët e të cilave nuk po lejohen të kthehen në atë pjesë.

Po e përsëris edhe një herë, të gjitha institucionet tona në veçanti kryeministri kanë përgjegjësi që drejtësinë ta çojnë në vend dhe kjo drejtësi çohet në vend vetëm duke vepruar drejt, sepse prona është e shenjtë për të gjithë. Prandaj, prona duhet të jetë e shenjtë edhe për qytetarët e pjesës veriore të Mitrovicës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Margarita Kadriu-Ukelli e ka fjalën dhe përgatitet pastaj zonja Lirije Kajtazi.

MARGARITA KADRIU-UKELLI: I nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Përafërsisht gjashtë vjet ishin pikërisht dy partitë në koalicion PDK-ja dhe LDK-ja, të cilat u morën vesh pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010 për ndryshimin e Ligjit zgjedhor, dhe jo vetëm.

Mirëpo, prej atëherë zotimet realisht mbetën vetëm në një letër pa vlerë dhe nuk u përmbushën. Bashkimi Evropian në vazhdimësi ka adresuar kritika të ashpra për shkak të neglizhencës së qëllimshme të reformës zgjedhore. Mirëpo, këto vërejtje, edhe pse u përfshinë në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, sikur nuk u bënë përshtypje qeveritarëve dhe kryetarëve të subjekteve politike. Partitë e mëdha si përfaqësueset kryesore të elektoratit kosovar kanë përgjegjësi për këtë dështim dhe neglizhencë, por tani është koha kur duhet të reflektojnë urgjentisht gjatë kësaj legjislature duke bashkëpunuar edhe me subjektet politike në opozitë, në mënyrë që përfundimisht ta kemi një reformë të mirëfilltë zgjedhore.

Reformimi i sistemit zgjedhor ekzistues duhet të jetë i orientuar patjetër në drejtimin i cili afirmon dhe garanton shprehjen e vullnetit qytetar. Brenda partive politike po diskutohet mbyllja e listave zgjedhore, mirëpo pa një reformë rrënjësore dhe të mirëfilltë të sistemit zgjedhor vetëm sa do sforcohen veprimet shpërfillëse të institucioneve dhe politikës karshi vullnetit qytetar. Propozimi për mbylljen e listave nuk duhet të shihet si zgjidhje për shmangien e manipulimeve të kandidatëve brenda të së njëjtës listë, njëjtë sikur rivendosja e bartësit e listës nuk duhet të shërbejë si mjet për liderët partiakë që t'i mbajnë larg kundër kandidatët eventual.

Kosova vazhdon ta ketë sistemin proporcional me listat e hapura dhe vetëm një zonë zgjedhore, nga ku u zgjodhën 120 deputetë, këta që jemi realisht në këtë përmbajtje. Nga rezultatet e zgjedhjeve të fundit, të mbajtura në vitin 2014, rezulton se deputetët vijnë nga 22 komuna, teksa 16 komuna të tjera nuk kanë asnjë përfaqësues në Kuvend. Në anën tjetër, në vitin 2011 Kuvendi e kishte miratuar një rezolutë nëpërmjet së cilës e mbështeste krijimin e më shumë zonave zgjedhore, e cila, si duket, edhe u harrua, që do të garantonte përfaqësim më të mirë të të gjitha komunave sipas fuqisë zgjedhore që e kanë.

Mirëpo, reformat zgjedhore, edhe pse jemi në vitin 2016, nuk ndodhi. Është shumë me rëndësi që ndryshimet në Legjislacion dhe sistemin zgjedhor në Kosovë të bëhen për të siguruar përfaqësim të drejtë qytetar. Duhet theksuar se në mesin e shumë ndryshimeve që duhet bërë duhet t'i kemi parasysh edhe propozimet e shoqërisë civile që pragu zgjedhor për subjektet politike të ulët në 3%, pasi pragu aktual prej 5% i favorizon partitë e mëdha dhe e dekurajon pjesëmarrjen e partive më të vogla dhe atyre rajonale. Pastaj, duhet hequr pragu zgjedhor për kandidatët e pavarur, kategori kjo e cila ka qenë e diskriminuar në të gjitha legjislacionet e deritanishme.

Të gjitha këto çështje duhet të diskutohen këtu, në Parlament, dhe është detyrë e Qeverisë ta adresojë me urgjencë reformën zgjedhore për diskutim e debat parlamentar në Kuvendin e Kosovës. Këto reforma janë në interesin e të gjithë qytetarëve dhe jo vetëm të ndonjë partie apo lideri të veçantë, i cili edhe mund të ketë mendimin e vet ndryshe nga shumica. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Lirije Kajtazi e ka fjalën, përgatitet zonja Emilija Rexhepi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar ministra,

Zbardhja e fatit dhe vendndodhjes së personave që na mungojnë që nga koha e agresionit të shtetit të Serbisë gjatë luftës së fundit dhe adresimi i mirëfilltë i nevojave të familjarëve të tyre, vazhdon të jetë preokupim i institucioneve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Kosova vazhdon të mbetet dosja e madhe e krimit të pa ndëshkuar. Sipas konventave ndërkombëtare krimi vazhdon deri edhe në kohën e zbardhjes së tyre dhe ndëshkimit. E kam thënë më herët dhe e përsëris tani do të ishte minimumi i humanes dhe seriozitetit i Qeverisë së tanishme serbe, mandej duhet ta përmendi edhe kishën ortodokse serbe e cila është vërtetuar sa herë që nxit urrejtjen, elitave intelektuale serbe dhe të gjithë atyre që kanë përgjegjësi të flasin edhe në këtë çështje, në çështjen e të pagjeturve.

Për shtetet dhe popujt normalë kjo gjë nuk duhet t'i takojë politikës edhe pse ka derivuar nga një politik e keqe dhe ne jemi dëshmitarë se qeveritë në Serbi shkojnë e vijnë dhe çështjen e të pagjeturve e kanë shndërruar në çështje politike dhe nuk kanë bërë minimumin e angazhimit për tu larguar nga kjo politik e keqe e cila ka planifikuar dhe realizuar vrasjen dhe zhdukjen e mijëra civilëve të pafajshëm.

Kjo është dëshmia më e mirë se shteti i Serbisë nuk ka hequr dorë nga politika kriminale ndaj popujve fqinjë. Është koha e fundit që vendet e botës së lirë dhe demokratike duke filluar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe BE-së, si garante dhe të demokracisë të bërë me dije politikës së kriminalizuar të Beogradit se ky profil i shtetit dhe i politikës së tillë nuk ka vend në mesin e familjeve evropiane, nëse vazhdon të mos heq dorë nga trashëgimia e tillë.

Madje, këtë e ka dëshmuar edhe një gjykatë ndërkombëtare siç është ajo e Hagës, dhe rastin më të mirë e ka nëse fillon të tregojë se ku ndodhen njerëzit tanë, të cilët padrejtësisht i ka marrë nga shtëpitë e tyre dhe ua ka humbur gjurmët. Ftojmë Qeverinë e Republikës së Kosovës që në agjendën e saj të bisedimeve me Serbinë para faktorit ndërkombëtar ta bëjë këtë temë të bisedimeve, çështjen e të pagjeturve në vazhdimësi, sepse ajo përkon me idealin human që njëkohësisht është shtyllë e civilizimit perëndimor.

Njëherësh, diplomacia jonë të jetë më aktive aty ku funksionon në shtetet ku ndodhet që direkt apo indirekt në çfarëdo forme të sensibilizojë qeverinë dhe opinionin e këtyre vendeve për çështjen e të pagjeturve dhe krimet e pandëshkuara në mënyrë që profili kriminal i politikës dhe shteti serb të vihet në pah me qëllim që këto vende të ndikojnë në dekriminalizimin dhe zgjidhjen e çështjes së të pagjeturve.

Gjithashtu, kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që këtë çështje të ndjeshme ta institucionalizojë në mënyrën më të mirë, ne e dimë që kemi ligjin por siç e dimë komisioni parlamentar quhet Komision Parlamentar për të Pagjetur ndërkohë që komisioni qeveritar quhet me një emër ndryshe - Komisioni Qeveritar për të Zhdukurit. Nuk është vetëm terminologji gjuhësore kjo, por është edhe terminologji juridike, prandaj edhe duhet të korrigjohet kjo në

vazhdim në bërjen e një ligji sa më mirë aq më tepër edhe në pjesën e beneficioneve për familjarët.

Po ashtu, është më se i nevojshëm koordinimi i punës ndërmjet faktorëve vendorë siç është edhe i nevojshëm investimi në ngritjen e kapaciteteve profesionale që merren me këtë fushë. Unë edhe një herë kërkoj më shumë përkujdesje nga institucionet e Republikës së Kosovës edhe për familjarët dhe një trajtim sa më të mirë institucional të tyre, sikurse që bëj thirrje për drejtësi më të madhe në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Të kishim inkurajuar që të na e sjellësh iniciativën, ta bëjmë edhe rezolutë dhe çdo vit, ose çdo ditë, në qoftë se ka nevojë, ta kalojmë derisa t'i prekim në ndërgjegje veçanërisht partnerët tanë, se Serbia duhet të bëjë më shumë për arsye se dihet që shumë familjarë të të pagjeturve, shoqata e tyre ka shumë të dhëna, si dihet nga organet e shtetit se pse ku janë këta njerëz dhe nuk po japin informacione. Veçanërisht po flas për varret e tyre, disa prej tyre. Si lloj initiative e hedhim në rezolutë, e aprovojmë si Kuvend përsëri.

Urdhëro, zonja deputete e ka prapë fjalën. Regjia, të lutem! Deputetes Lirije Kajtazi t'i aktivizohet mikrofon.

LIRIJE KAJTAZI: Nëse mundem ta plotësoj këtë dhe me kërkesën tuaj, ne e kemi marrë historikun komplet edhe të angazhimeve të Kuvendit, institucioneve tjera ka rezoluta, rekomandime, kështu që me komisionin qeveritar dhe me të gjithë aktorët tjerë që janë të përfshirë në këtë fushë kemi bërë grupin punues për ta ofruar atë që është konkrete për të avancuar në këtë drejtim.

KRYETARI: Kërkoj falje për deputetët, të mos e zgjas, por kanë ata disa të gjetura në takimin të cilin e kemi pasur, e kanë informacione konkrete. Le të jetë një rezolutë më unike dhe t'i kërkojmë zyrtarisht edhe Republikës së Serbisë veçanërisht në dialogun në të cilin e kemi në Bruksel, por në të njëjtën kohë edhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, për arsye se kanë informacione edhe më konkrete që dihet më saktë.

Po, urdhëroni! Vjosa Osmani e ka fjalën, por Emilijes ia kam premtuar fjalën.

VJOSA OSMANI: Shumë shkurt, meqenëse është çështja e njëjtë. Kërkoj falje prej zonjës Rexhepi.

Ky Kuvend ka miratuar edhe rezoluta, të cilat kanë vënë parakusht zgjedhjen e çështjes së të pagjeturve për të vazhduar dialogu. Do të thotë, ka qenë parakusht që të mos të ketë më bisedime me Serbinë pa u trajtuar kjo çështje dhe siç e dini nuk është respektuar në asnjë moment, as në mandatin e kaluar, as në këtë mandat.

Pra, nuk ka qenë problemi që s'kanë ekzistuar rezoluta, të cilat kanë qenë shumë konkrete me kërkesat e tyre, por problemi është që asnjëherë nuk janë marrë parasysh nga ana e Qeverisë.

Mirëpo, është një çështje e cila duhet të trajtohet jashtëzakonisht me seriozitet të madh nga ky Kuvend, e ky është deklarimi i ministres që tani është për dialog në mandatin e kaluar, se të

dhënat për të pagjeturit e Kosovës janë në sirtarët apo arkivat e Ushtrisë jugosllave. Pra, ajo ka deklaruar në këtë Kuvend që të dhënat janë aty dhe se janë shumë afër për t'i marrë. Kjo ka ndodhur para disa vjetëve dhe nuk është bërë asnjë hap konkret.

Në qoftë se ne e dimë ku janë ato të dhëna, ku janë ato dokumente të cilat do ta zbardhnin fatin e 1 666 të pagjeturve, atëherë si Kuvend duhet të jemi shumë më konkret me kërkesat tona në raport me Qeverinë, sepse nuk mund të gjuhen fjalë të tilla në institucionin më të lartë përfaqësues, thuhet “janë në arkivin e Ushtrisë jugosllave”, e pastaj të mos ndërmerret asnjë hap për disa vjet më radhë.

KRYETARI: Faleminderit! Komisioni e ka bërë një punë të jashtëzakonshme zonja Lirije Kajtazi, por unë e di se ata kanë informacione të tilla nga këta familjarë. Kjo ishte arsyeja që ta bëjmë edhe një rezolutë se ka informacione konkrete. Vazhdojmë me zonjën Emilija Rexhepi, pastaj bëhet gati deputeti Bislim Zogaj.

EMILIJÀ REDŽEPI: Hvala, gospodine predsedniče!

Poštovani predstavnici Bošnjake nacionalne zajednice, gde vi živite u opštini Prizren, Peč, Leposavić, Mitrovica i Istog, Dragaš, u moje lično ime, u ime partije koje ja zastupam želim da uputim javne kritike kabinetu, gospodina našeg premijera, gospodine Isa Mustafa, koji nedavno posetio jednu političku partiju, odnosno u sklopu njegove službene posete svim građanima Republike Kosovo, imao je posetu opštine Rečane, gde je naš ministar, gospodin Rasim Demiri, prekršio protokol i zloupotrebio tu posetu. Želim da znam da li je to uređeno svesno ili nesvesno, namerno ili nemamerno, želim objašnjena od Kabineta našeg premijera.

Bošnjaka zajednica nije dekorativna zajednica, i ona ima svoje legitimne predstavnike, kako u Vladi, taku i u Parlamentu, i na lokalnim nivoima, ima svoju problematiku koja je muči i koju stalno iznosimo ovde već nekoliko mandata. Želim istaći javno da proces decentralizacije, odnosno dobijanja opštine Rečane već 17 godine sa ugovorlači, i želim objašnjenje zašto do toga nije došlo, želim ugovoriti javno o velikoj nezaposlenosti naših stanovnika u svim opštinama, želimo javno istaći kritike o velikim vladinim neulaganjima u našim sredinama poput ekonomskog razvoja, poput razvoja i podstreka poljoprivrednih dobara. Želimo javno istaći da bošnjačke nevladine organizacije dobijaju jako, jako mali broj grantova od strane određenih resursnih ministarstava u našoj Vladi. Bošnjački mediji i bošnjačke radiostanice, veb portali u opštine dobijaju finansijska sredstva. Jednu zajednicu ako želite uništiti onda trebata je udarati na obrazovni sistem i na informativni sistem. Ona će se sama unapred sama uništiti, ne treba niko da se trudi.

Tražim objašnjenje od gospodina premijera naše Vlade, da li je njegov kabinet napravio propust tokom njegove posete ili da li je gospodin Rasim Demiri možda zloupotrebio njegov položaj? Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bislim Zogaj e ka fjalën, të përgatitet Shaip Muja.

BISLIM ZOGAJ: E nderuar Kryesi e Kuvendit,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë dhe kolege,

Të gjithë jemi dëshmitarë të spektaklit të para dy ditësh për bastisjen dhe arrestimin e disa qytetarëve të Kosovës.

Edhe unë si të gjithë ata që ia duan të mirën Kosovës, jam që të zbatohet ligji për të gjithë pa dallim ndaj qytetarëve. Personalisht jam munduar, kam sakrifikuar dhe do të mundohem tërë jetën time që të bëj më të mirën për vendin tim, por spektakli i para dy ditësh ishte për mua, sa i paarsyeshëm, po aq edhe i trishtueshëm. E them i trishtueshëm, sepse pamjet që u panë te shtëpia e Azem Sylës, deputet i Parlamentit të Kosovës, krijonin përshtypjen se aty po arrestohej ndonjë kriminel ndërkombëtar, e Azem Sylja asnjëherë nuk ishte i tillë dhe asnjëherë nuk i kishte ikur drejtësisë, përkundrazi ai luftoi për drejtësi. Por, ajo që për mua ishte edhe më e trishtueshme, ishin lajmet, komentet, paragjykimet e deri te dënimet e këtyre personave, ende pa u ngritur aktakuza.

Konkretisht do të ndalem tek paragjykimet, etiketimet dhe akuzat më banale, që thuhetse bënëin gara se cili do të bëhej kampion i këtyre shpifjeve për Azem Sylën. Azem Sylja është ndër më meritoret, jo vetëm në Parlamentin e Kosovës, por edhe në tërë trojet shqiptare me kontributin e tij, që dha për lirinë e Kosovës. Kur lexoja shkrimet në portalet e pardjeshme, jo në të gjitha, por në disa. Dhe, në disa televizione të krijohej përshtypja se bëhej fjalë për akuza ndaj Slobodan Milosheviqit apo Dragolub Dragoviqit, por në realitet nuk bëhej fjalë për këta që na dënuan, na torturuan, na vranë, por flitej për njeriun që tërë jetën ia kushtoi Kosovës.

Kishte tituj në portale, thuhetse kishin mbetur mangut pa u shkruar në të kaluarën, që nga paslufta e deri më sot, si kriminel, kapo, bandë, vrasës, mafiozë, krim i organizuar, e çfarë nuk u tha tjetër. Kur i lexoja këto portale, edhe pse gjithëherë jam munduar të mos bëj krahasime të tilla, kësaj here nuk munda ta tejkaloj pa thënë, se këto shkrime tendencioze janë një vazhdimësi e UDB-së serbe, e cila po vazhdon ende ta ketë ndikimin e vet në Kosovën e dirigjuar nga Dragoljub Zdravkoviqi më ka dënuar edhe mua me shokët e mi. Përmes Bllacës e deri te disa shqipfolës, që po bëjnë argatin e Serbisë me shkrime e deri te dëshmitë e rrejshme në Prokurori. Këtë e them duke u nisur nga fakti, se Ayem Sylja gjithë jetën e tij kishte punuar për Kosovën, duke e kundërshtuar Serbinë, kurse Serbia në kohën e saj e kishte burgosur, e kishte torturuar, e kishte përndjekur, kurse sot nga pamundësia për ta bërë këtë, përsëri përmes njerëzve të saj po mundohet ta njolloso figurën e tij.

Ju lutem, një profesor për të cilin shumë gjenerata flasin me nostalgji për kohën kur ishin nxënës të tij, një person i cili ishte i gatshëm edhe të vdes për lirinë e Kosovës, tani na është shndërruar në një vrasës, kriminel, uzurpator, zhvatës dhe të merret me krim të organizuar!? Jo, kurrën e kurrës! Prandaj, edhe përkundër të gjitha këtyre shpifjeve dhe akuzave që po bëhen gjatë gjithë kohës së pasluftës, sado që patën ndikimin e vet negativ tek disa qytetarë të Kosovës, ajo as që u vërejt në rrethin ku jeton Ayem Sylja. Kjo u vërtetua në dy palë zgjedhjet që u bënë në vitin 2010 dhe 2014, Azem Sylja doli personi më i votuar. Kjo ndodhi sepse bashkëvendësit e tij e njohin shpirtin e tij liridashës, komunikues dhe ofrues për të gjithë qytetarët e sidomos, për kategoritë e luftës. Po, veprimi i tij i djeshëm për dorëheqje nga deputeti i Parlamentit të Kosovës për t'i dhënë mundësi drejtësisë të veprojë e lirë, a nuk flet mjaft për gatishmërinë e tij që të jetë i barabartë me të gjithë qytetarët para drejtësisë? Cili deputet apo pushtetar deri më sot ka vepruar kaq shpejt? Dikush mund të thotë: "Po, përse ai po i ikën drejtësisë?" Jo! Ai nuk po ikën. Ai sot do të lajmërohet para drejtësisë.

Për Azem Sylën me muaj të tërë ishte shkruar, se kishte marrë pension invalidor dhe se kishte keqpërdorë paranë e Zvicrës, por kur Gjykata e Zvicrës e shpalli pafajësinë e tij, nuk u shkrua as edhe një fjalë. Ishte intervistuar dhe hetuar edhe nga EULEX-i edhe për organizimin e vrasjeve të personave të ndryshëm, ishte shkruar shumë, por pas hetimeve dyvjeçare nuk pati argumente për tu ngritur aktakuza. Ishin ndërprerë hetimet dhe nuk u shkrua asnjë fjalë.

E unë po ju them, pas gjithë këtyre akuzave që sot i bëhen Azem Sylës do të dalë i pafajshëm e ju, as atëherë nuk do të shkruani për pafajësinë e tij, sepse do të jeni të turpëruar. Por, me rëndësi është se kush do të mbajë përgjegjësinë për ato shqetësime që iu krijuan Azem Sylës dhe familjes së tij? A thua, do t'ju vrasë ndërgjegjja!? A thua, do të pendoheni një ditë për këto veprime tuaja, kur për një hero të gjallë, që do ta kishte për krenari kombëtare çdo popull tjetër, ju e akuzuat në mënyrën më të poshtër të mundshme!? A keni menduar se një ditë do t'ju gjykojnë edhe fëmijët tuaj për këto veprime? Të shpresojmë se do të këndelleni sa më parë!

KRYESUESI: Faleminderit! Shqip Muja e ka fjalën, të përgatitet Gëzim Kelmendi.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Meqenëse, sërish edhe sot ka mungesë të ministrave, por është një e mirë, që ministri i Transportit është dhe ndoshta u asiston me i transportua ministrat dhe Qeverinë që të vijnë ngadalë këtu për të diskutua dhe për t'i dëgjuar disa tema, të cilat dje i prekëm pakë. Unë sot do të fokusohem... e keni edhe ministrin e Mbrojtjes, i mbron, por ka ikur fakti militar në Parlament, nuk ka rrezikshmëri, kështu që mund të merrni edhe ujë për të pirë.

Dje biseduam pak lidhur me disa probleme, të cilat unë propozoj dhe ju ftoj, se janë mbledhur shumë probleme të cilat ne nuk po kërkojmë “kokën e turkut”, por po kërkojmë zgjedhjen e problemeve, t'ju japim për zhvillimin ekonomik. Secili lider sot që po flet e ka humbur kuptimin e veprimeve, ose diskutimeve politike, nëse nuk garanton për qytetarët e Kosovës zhvillimin ekonomik. Dhe, ne duhet të fokusohemi seriozisht në ato pika ku kemi t'i zhvillojmë dhe angazhime tjera ku mund të sjellim zhvillime. Ne dje folëm për Postën si problem, i cili duhet seriozisht me pa edhe Kuvendi, sepse ka shkelje ligjore.

Unë sot do të flas për çështjen e “Ferronikelit”, meqenëse disa kolegë të mi thanë, se nuk ka lidhje me çështjen e ndërmarrjeve publike. Në mënyrë indirekte në biznese, bizneset sot nuk jetojnë të pavarura si oaza. “Ferronikeli” është i varur nga Korporata Elektroenergjetike e Kosovës dhe merr rrymën në linjë të dedikuar, që është linjë e veçantë dhe paguan KEK-ut 10 milionë euro në vit korrent. Unë vij nga ajo zonë, ku jam votuar shumë nga Drenica dhe unë jam duke e pa që është një rrezikshmëri për mbylljen e atij impianti, i cili do të lërë me mijëra familje pa bukë. Dhe, kam ngritur shqetësimet pse me dy “kute” të maten kompanitë? Nëse “Sharr-Cem” merr 29 euro MW-in e bën pagesën dhe e ka produktin e shitur 100%, sepse nuk i plotëson kushtet e mjaftueshme për çimento, po ashtu edhe Trepça, ndërsa këta e kanë 29 euro MW-in. Dhe, kjo është një diskriminim pozitiv, i cili nuk duhet na ta lejojmë dhe Qeveria duhet seriozisht të angazhohet. Në pyetjen që i kam bërë Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, e cila është në kuadër të Parlamentit si raportuese, kanë thënë se duhet dikush t'i paguajë borxhet e këqija. Kur është privatizuar KEDS-i, ai i ka marrë borxhet e këqija për t'i paguar dhe i ka ditur obligimet, por nuk mund të merren nga ndonjë kompani, e cila sot rrezikohet që në këtë krizë ekonomike globale, të ketë një rënie kaq të fuqishme.

KEDS-i çka fiton nga “Ferronikeli” dhe çka shpenzon? KEDS-i shpenzon 9 centë për ta prodhuar një faturë dhe i merr 9 milionë euro të pastra në arkën e vet, por nuk i merr Qeveria e Kosovës dhe nuk i marrin qytetarët me atë diferencë. Ndërsa, Korporata Elektroenergjetike shet afërsisht 55 milionë euro sasi. Nga ajo që unë kam lexuar dhe kam biseduar me sindikatat e “Ferronikelit” 55 milionë ka shitje të rrymës dhe diku nga 20% përfitimi i tyre është 1,5 milion në muaj humbje. Dhe, në tërësi në total, në vit është 16 milionë, që është pothuajse totali i pagave të punëtorëve të Korporatës elektro-energjetike.

Nëse “Ferronikeli” mban 40% eksportin e Republikës së Kosovës dhe kolegët tanë ekonomistë e dinë fort mirë, se nuk mund të bëjmë një arsyeshmëri, sepse sa më shumë që të eksporton ne do të tatohem i dhe do të shkojnë mjetet në arkën e shtetit. Prandaj, ne seriozisht... edhe vizitat që i ka pasur kryeministri në “Ferronikel”, nuk ka dhënë ndonjë shpresë e cila jep kushte të favorshme. Unë kam qenë kritikues shumë i madh i “Ferronikelit” për ndotjen e ambientit, por unë vij nga ai regjion, ku jam votuar. Dikush pyeti, “Cilat janë arsyt tuaja?”. Po, janë të votuesve të mi, që më kanë ulur mua këtu dhe ata do t’i mbroj vazhdimisht, sepse ata nesër do të jenë çështje sociale, nesër do të na vijnë këtu. Dhe, atyre nesër ne s’do dimë çfarë t’u themi. Po, përkundrazi, regjioni i Drenicës është regjioni i vetëm, i cili ka një ekonomi të cilën duhet ta ruajmë.

Tjetra, Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ofron qasje, nuk i asiston qasje në shfrytëzimin e mineralit, që e ka “Ferronikeli” në Gadime. Kjo do të thotë, ne si deputetë duhet dhe obligohemi që të angazhohemi edhe tek Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe kur shihen këto të gjitha dhe kur kam marrë informacion që e njëjta kompani në Maqedoni vepron me mineralin tonë, transportohet nga minerali jonë nga Kosova në Maqedoni, në FENI të Kavadarit dhe atje Maqedonia e faturon 33 euro megavatin, diferenca është do të thotë 16 euro më shumë në Republikën e Kosovës, ku edhe Republika e Maqedonisë nuk ka ndonjë favor, ose ndonjë stabilitet energjetik.

Unë ju kërkoj, kolegë të nderuar, që së bashku me ministrat përkatës të Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Financave me Qeverinë dhe ju si komision, të uleni dhe të kërkon Komisioni për Zhvillim Ekonomik, po edhe Parlamenti në përgjithësi, sepse të gjithë ne po dalim po themi: “do të rregullojmë mirëqenien...”. Nëse në Republikën e Kosovës regjioni më i goditur pas luftës dhe populli, i cili pothuajse ka vuajtur historikisht - Drenica, goditet që t’i humb kjo industri, atëherë, kur thash dje që do të ketë zhvillime të paparashikueshme sociale, nuk do të jenë ato të formave të cilat jemi mësuar, për fakte fiktive politike me bë zhurmë, po bëjnë vërtetë revolucionet ata që e kanë barkun bosh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Gëzim Kelmendi, le të përgatitet Nuredin Ibishi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë dhe kolege deputetë të nderuar,

Mungesa edhe e sotme e pjesës dërmuese të ministrave, konkretisht Kabinetit qeveritar, na pamundëson mua dhe të tjerëve që të jemi produktiv në debatet tona, për faktin se ka kohë të gjatë që nuk kemi pasur seanca plenare dhe çështja, temat e ndryshme që të jemi më produktivë, na pamundëson në mungesë të ministrave.

Ne e dimë që Kosova është duke u ballafaquar me shumë sfida, të mëdha e serioze, ndër to vazhdon fatkeqësisht të jetë ende pjesë e realitetit tonë krimi i organizuar dhe korrupsioni për çka edhe kemi raportin e fundit të State Departamentit Amerikan dhe raporteve me rend të progresit për çdo vjet, prandaj në mungesë të kabinetit qeveritar, pjesës dërrmuese, përveç dy ministrave prezentë dhe në pamundësi që të jemi më produktivë në debate e diskutime, unë e kam një kërkesë të drejtpërdrejtë për Kryesinë e Kuvendit dhe i nderuari kryesues shpresoj se do t'ia procedoni Kryesisë pasi që ju e dini që nga fusha ime jam profesor doktor nga fusha e mjekësisë, e lidhet drejtpërdrejt me shëndetin publik kryesisht të gjithë deputetëve dhe gjithë mysafirëve që frekuentojnë Kuvendin e Kosovës. Fjalën e kam për skanerët e sigurisë për të cilët unë kam një kërkesë të drejtpërdrejtë për Kryesinë e Kuvendit që të bëjë largimin e tyre për dy arsye madhore - mungesa e efikasitetit të tyre që nuk kanë treguar kohët e fundit, veçanërisht kur kemi pasur qëndrimet e opozitës së tyre dhe arsyeja e dytë, që është madhore, e rrezikon në kuptim të plotë shëndetin dhe sigurinë publike të deputetëve, deputeteve, stafit diplomatik, gazetarëve, Administratës dhe të gjithë atyre që janë pjesë e Kuvendit.

Kur flas për mungesën e efikasitetit, ne kemi pa në muajt e kaluar se skanerët nuk e kanë kryer punën si duhet. Kemi pasur në vazhdimësi futjen e gazit lotsjellës, bile-bile edhe e kemi qëndrimin e kryetarit të Kuvendit të Kosovës kur e ka arsyetuar qëndrimin pse është dashur të futë policinë në sallën e Kuvendit dhe arsyetimi ka qenë që disa nga deputetët kanë pasur edhe armë me veti. Prandaj, skanerët në këtë punë kanë dështuar nga se nuk kanë arritur të parandalojnë as gazin lotsjellës, e as armët nga ana e deputetëve.

Kjo do të thotë, se mosefikasiteti i tyre është një armë e fortë që ata nuk kanë vend më në Kuvendin e Kosovës dhe nuk do të ishte mirë që të kanë vend në Kuvendin e Kosovës. Dhe, e dyta, rrezikimi i sigurisë, konkretisht të shëndetit publik dhe të gjithë atyre që hyjnë në Kuvendin e Kosovës dhe veçanërisht nga këta skanerë që prodhojnë dozë të rrezatimit që fatkeqësisht nuk është e kontrolluar por edhe ata që e kanë të kontrolluar e kanë një dozë të rrezatimit dhe nga ky rrezik i këtyre skanerëve më së shumti janë të ekspozuar koleget deputete, veçanërisht ato që janë shtatzënë dhe në muajt e parë të cilët nuk janë konstatuar shtatzënia e tyre nga se rrezikohet drejtpërdrejt fryti i tyre.

Prandaj, si masë alternative, i nderuar kryesues i Kuvendit, me qëllim që Kuvendi të shtojë masat e sigurisë, atëherë ka metoda tjera alternative. Ne e dimë që Policia e Kosovës fatmirësisht është prej institucioneve më kredibile dhe me performansën më të mirë, ka metoda tjera në vend të skanerëve, metoda të kontrollit detal qoftë të çantave e sakove dhe të kontaktit fizik apo manual janë dëshmuar shumë herë se janë më të mira se skanerët, prandaj merreni parasysh këtë kërkesë serioze, e cila rrezikon shëndetin publik dhe njëherë e përgjithmonë largoni nga përdorimi ata skanerë të cilët nuk janë dëshmuar efikas. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Nuredin Ibishi, le të përgatitet deputeti Nezir Çoçaj.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryesues,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar të pranishëm dhe qytetarë,

Kuvendi i Kosovës si institucion përfaqësues i popullit dhe harxhues i parasë, të taksapaguesve kosovarë, të cilët duhet të kenë edhe përgjegjësinë për përmbushjen e mandateve dhe detyrave të veta.

Deputetët e kësaj legjislature në vend që të ngrenë nivelin e punës, pas bojkotit të opozitës, duket se në këtë situatë po solidarizohemi me ta. Gjatë katër muajve të kaluar të këtij viti dhe me këtë muaj që po përfundon, janë mbajtur vetëm 8 seanca, prej të cilave dy protokollare dhe atë për zgjedhjen e Presidentit, që i bie vetëm 6 dhe kur krahasohet vetëm me vitin e kaluar i bie se janë diku 13 më pak.

Nga 14 komisioneve funksionale, vetëm 5 prej tyre deri tash, kanë bërë mbikëqyrjen apo pranimin e raporteve nga autoriteti, nga ministrat, apo nga autoriteti përgjegjës, ndërsa 9 prej tyre ende s'e kanë bërë pranimin e raporteve apo mbikëqyrjen në aspektin e kompetencave funksionale.

Pra, nëse e vlerësojmë performansën e punës së Kuvendit me komisionet funksionale si në aspektin kuantitativ dhe kualitativ del se Kuvendi është larg përmbushjes së mandatit.

Deri sa puna e Kuvendit është e dukshme dhe e matshme nga opinioni, për shkak edhe të transmetimeve që bëhen nga mediumi publik, duke përfshirë shoqërinë civile, palët e interesit, të mediave dhe vetë qytetarët, puna në komisionet funksionale është minimizuar.

Komisionet funksionale mendoj se duhet të dinamizohen në punën e tyre me qëllim që ta përmbushin mandatin.

I nderuar zoti kryesues,

Deputetë,

Udhëheqës të komisioneve funksionale,

Trupave tjerë të Kuvendit dhe Administratës,

Ju drejtohem që ne të gjithë duhet ta intensifikojmë punën, sipas kompetencave tona, pra edhe në mundësi të delegimit të autoritetit me qëllim të përmbushjes së mandatit të Kuvendit të Kosovës.

Mendoj se Kuvendi duhet gjithashtu të ngrejë bashkëpunimin ndërparlamentar, si në rajon, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Në fund, i drejtohem gjithashtu dhe në veçanti deputetëve të partive opozitare që të kthehen në Kuvend me qëllim që të kontribuojmë së bashku në përmbushjen e performansës dhe detyrave të Kuvendit. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Çoçaj është i fundit.

NEZIR ÇOÇAJ: I nderuar zoti nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja që do ta paraqes sot, ka të bëjë me protestën e para dy ditëve të punëtorëve të Postës së Kosovës, protestë e cila ka të bëjë me mosrealizimin e marrëveshjes së Postës së Kosovës dhe të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Sa për të sqaruar, Posta e Kosovës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kanë pasur disa takime dhe një marrëveshje të finalizuar për t'u nënshkruar në maj të vitit 2015 lidhur me shpërndarjen e skemave dhe ndihmave sociale nëpërmjet Postës së Kosovës por që një orë para nënshkrimit, është anuluar. Aktualisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale paguan provizion 1.5 euro për shpërndarjen e skemave sociale ndërsa Posta e Kosovës ka ofruar 1.3 euro duke ia mundësuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale kursimin prej 60 mijë euro në vit, ndërsa përfituesit e skemave sociale nuk do të jenë të detyruar të paguajnë për mirëmbajtjen e kontove apo edhe të udhëtojnë deri në qytet për t'i tërhequr këto ndihma, që në total si kosto shkon deri në 300 mijë euro në vit.

Për ta fituar këtë të drejtë të shpërndarjes së skemave sociale, Posta e Kosovës i ka siguruar aprovimet e nevojshme relevante të Bankës Qendrore të Kosovës, respektivisht nga Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit si dhe nga Ministria e Financave respektivisht nga Drejtoria e Thesarit.

Po ashtu, ka investuar edhe në sistemin e teknologjisë informative, i cili edhe ka rezultuar të jetë i suksesshëm.

Siç dihet, Posta e Kosovës është e licencuar për ofrimin e shërbimeve financiare, jo bankare në Republikën e Kosovës dhe si e tillë ka lidhur shumë marrëveshje me shumë institucione për ofrimin e këtyre shërbimeve, siç janë: Shërbimet e pagesave të rrymës, faturave të ujit, pagesave të studentëve, tatimet, kundërvajtjet e tjera.

Pra, nëpër zyrat postare qarkullojnë rreth 80 milionë euro në vit.

Duke u bazuar edhe në letrën që na është shpërndarë dje, më 15 dhjetor të vitit 2015 Ministria ka shpallur tender për shpërndarjen e ndihmave sociale, por që mund të konkurrojnë vetëm bankat private, gjë që është në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik.

Duke i pasur parasysh ë gjitha këto, mendoj se Qeveria duhet të ketë parasysh që shpërndarja e këtyre skemave sociale do të ndihmonte këtë ndërmarrje publike e cila ka të punësuar mbi 1 mijë punëtorë dhe e ka rrjetin më të gjerë të shtrirë në tërë territorin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj se nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim. Kemi abuzuar një çik me kohën dhe shpresoj që herëve tjera do ta respektojmë strikt afatin kohor të diskutimeve në këtë pikë të rendit të ditës.

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjatë 60 minuta.

Për këtë seancë janë parashtruar 4 pyetje parlamentare.

Deputetja Njomza Emini, po më duket s'qenka këtu.

Deputeti Bekim Haxhiu, as ai s'qenka këtu. E ka pyetjen për ministrin Kujtim Shala.

Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për zëvendëskryeministrin Kujtim Shala.

A dëshiron të bësh pyetjen, apo do të jetë ministri këtu dhe ka menduar do të kryhej dje, e unë i thashë se e kemi shtyrë dhe hequr prej rendit të ditës, e me siguri se ka menduar që sot s'do ta kemi këtë si çështje të rendit të ditës, dhe kishte me ardhur.

Deputetja Alma Lama, pyetje për ministrin Skender Hyseni.

A është deputetja Lama këtu? S'është!

Atëherë konstatoj se edhe kjo pikë e rendit të ditës është shteruar dhe besoj që në seancën e ardhshme do të jenë këtu ministri Hyseni, ministri Shala dhe zoti Rrahmani. Faleminderit!

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Si duket, nuk kemi kuorum. Le të numërohen sa deputetë janë të pranishëm. Janë 49.

Atëherë e japim pauzë prej 20 deri 30 minuta, dhe i lus deputetët të jenë të pranishëm.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Kisha kërkuar që kryetarët e grupeve parlamentare të bisedojnë me kolegët tanë deputetë, sepse e di, disa kanë arsye.

Ne do të provojmë edhe një herë, në orën 13:00 ta kryejmë drekën. Por, në qoftë se e vazhdojmë, nuk mund të vazhdojmë pa kuorum. 51 deputetë janë të pranishëm. Nuk është vendimmarrje... Ose qëndrojmë deri të bëhet kuorumi.

Atëherë, kur ta përfundoni drekën, konsultoheni edhe me kolegët tanë deputetë dhe në orën 13:00 jemi bashkë prapë në këtë sallë.

(Ndërhyrje)

Atëherë, në orën 13:15 të jemi këtu!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, po e vazhdojmë seancën.
Ndërkohë, presim që të vijnë edhe deputetët.

Jemi në pikën e rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Akademinë e Drejtësisë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që para deputetëve ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

HAJREDIN KUÇI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës, zoti Veseli,
I nderuar kryeministër Mustafa,
Të nderuar deputetë,
Anëtarë të Qeverisë,
Më lejoni që para jush të paraqes për miratim Projektligjin për Akademinë e Drejtësisë, i cili do të kompletojë arkitekturën institucionale të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës. Shkurtimisht, mund të them dhe t'i prezantoj disa argumente bazë të këtij projektligji.

Me këtë projektligj do të themelohet Akademia e Drejtësisë së Republikës së Kosovës si institucion tërësisht i pavarur. Akademia do të zbatojë politikën dhe strategjitë në bashkëpunim të plotë dhe në koordinim me Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe me Këshillin Prokurorial, i cili ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të këtyre dy këshillave, respektivisht të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në vendin tonë.

Funksioni primar i akademisë do të jetë ofrimi i trajnimeve dhe edukimit, para së gjithash për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe për stafin gjyqësor dhe për atë prokurorial, që janë kategori të veçanta dhe ndikojnë drejtpërdrejtë edhe në ngritjen e cilësisë së funksionimit të sistemit gjyqësor të ne. Akademia do të ofrojë edhe trajnime për profesionet e lira, përfshirë noterët, avokatët, ndërmjetësuesit dhe përmbaruesit, me kërkesën e tyre dhe participimin financiar të tyre, duke bërë kështu që akademia do të kontribuojë që me mjete vetjake ta mbajë veten, ndoshta edhe përjashtimisht, nga Buxheti i Kosovës.

Akademia e Drejtësisë do të organizojë edhe trajnime për specializime të tjera, përfshirë edhe kandidatët për provimin e jurisprudencës, për çka do ta përmbushë një zbrazëti që ka ekzistuar deri më tani. Me këtë ligj ndahen qartë kompetencat e akademisë, si institucion trajnues të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial si institucione përzgjedhëse dhe kualifikuese për gjyqtarë dhe prokurorë të Republikës së Kosovës.

Ky projektligj ka gjithsej 30 nene dhe është i ndarë në 6 kapituj dhe rregullon fushëveprimin e kësaj akademie. Duke marrë parasysh rëndësinë dhe koordinimin e plotë që kemi bërë me Këshillin Gjyqësor, me Institutin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial dhe me partnerët

tanë ndërkombëtarë, ju ftoj që ta miratojmë dhe pastaj me sugjerimet tuaja do ta themelojmë këtë akademi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar ministër!

Pas prezantimit të projektligjit, të nderuar deputetë, hap debatin për diskutim në parim. E ftoj nënkryetaren e Komisionit Funkcional për Legjislacion që ta marrë fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar dhe ju kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 19.4.2016 e shqyrtoi Projektligjin nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

- Të miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë.

Faleminderit!

KRYETARI: Tani radhën e kanë kryetarët, ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Do të shkojmë në mënyrë elektronike. Urdhëroni zonja Halimi për Partinë Demokratike të Kosovës.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për Akademinë e Drejtësisë dhe duke u nisur nga fakti, se ky projektligj unifikon kompetencat në kuadër të një institucioni, të cilat kanë të bëjnë me përgatitjet profesionale, trajnimet në fushën e prokurorisë, gjyqësisë dhe segmenteve tjera të drejtësisë. Andaj, si të tillë ky grup parlamentar e përkrah në parim aprovimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, deputeti Armend Zemaj.

ARMDEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj, që ka të bëjë me themelimin e Akademisë së Drejtësisë.

Duke marrë parasysh se ne deri më tani kemi pasur Institutin Gjyqësor të Kosovës, i cili është marrë me trajnime të gjyqtarëve dhe prokurorëve, qoftë ata paraprakë, qoftë në procedurën paraprake, qoftë me ata pas emërimit të tyre, duke u harmonizuar edhe me rregullativën ligjore të re, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial edhe ne i japim përkrahjen në parim.

Sido që të jetë, në brendinë e projektligjit ne mendojmë se gjatë dy leximeve do të japim propozimet tona shtesë, që ka të bëjë me konkretizimin e mandatit të akademisë, sidomos në saktësimin e fushës, që ka të bëjë me trajnimin plus edukimin, sepse janë dy gjëra që kërkojnë

shqyrtim të kujdesshëm, sepse gjyqtarët dhe prokurorët siç dihet edhe me legjislacionin në fuqi, vetëm e kalojnë një fazë të kësaj procedure akademike. Dhe në aspektin tjetër, ajo çka është pjesë e zgjerimit, është se edhe anëtarët që janë pjesë e Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor do të kenë hapësirë për trajnime, sidomos me njohuritë e ligjeve të reja, por mbi të gjitha me avancimin e sistemit të drejtësisë në vend.

Ne i japim përkrahjen në parim dhe kontributin tonë do ta japim ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! Danush Ademi nga Grupi Parlamentar “6+”.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për Akademinë e Drejtësisë 05/L-095 dhe në parim do ta përkrahë këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar! Nuk ka të lajmëruar tjetër për diskutim, nga grupet parlamentare. Nga grupet parlamentare s’ka të tjerë, pa grup s’ka. Abdyl Ymeri nga deputetët e ka kërkuar fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sistemi i drejtësisë në Kosovë në tërësinë e tij ende nuk është në nivelin e kënaqshëm, kur dihet se për një kohë të gjatë është punuar me një konglomerat të ligjeve dhe procedurave arkaike të sistemit të kaluar dhe rregullore të aprovuara nga UNMIK-u dhe për këtë ishte krijuar një përshtypje, se Kosovës po i mungonte drejtësia e mirëfilltë.

Mirëpo, pas pavarësisë së Kosovës sistemi i drejtësisë në Kosovë ka pësuar disa ndryshime dhe një përmirësim të konsiderueshëm gjatë këtyre viteve, si rezultat i reformave të vazhdueshme, në mënyrë që të krijohet një sistem i drejtësisë i qëndrueshëm transparent, i pavarur, i bazuar në parimet e shtetit të së drejtës.

Por, përkundër këtyre ndryshimeve të bëra ende nuk e kemi arritur stadin e duhur të funksionimit të një sistemi të drejtësisë të pavarur, sepse sipas raporteve të shumta, besueshmëria e qytetarëve në këtë sistem si matësi më i mirë, ende është në nivelin më të ulët. Unë konsideroj, se themelimi i Akademisë së Drejtësisë e cila do të ofrojë shërbime të edukimit të vazhdueshëm ligjor për prokurorë gjyqtarë dhe praktikues të tjerë të ligjit, do të jetë qendra kryesore e arsimit të vazhdueshëm ligjor, e cila do të mundësonte fuqizimin e sistemit të drejtësisë.

Synimi ynë në këtë kuadër të akademisë si institucion i edukimit ligjor, është që të ketë programe të unifikuara për trajnime unifikuese dhe një interpretim unik të praktikave dhe të ligjeve të zbatueshme në Kosovë, për praktikuesit e ligjit, por në të njëjtën kohë që të arrihet edhe qëllimi kryesor, që është përgatitja sa më cilësore e kadrove të reja, ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, noterëve, ndërmjetësuesve, përmbaruesve privatë dhe të

administratorëve falimentues, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës në punën e tyre të mos ndikohen nga askush, do të thotë të jenë të pavarur, të paanshëm dhe efikas.

Duke lexuar me kujdes projektligjin, përkufizimin dhe qëllimin e tij, si dhe materien që është marrë për bazë për hartimin e tij, duke marrë parasysh rekomandimet dhe propozimet e Këshillit Gjyqësor, si dhe praktikën e vendeve të tjera, e po ashtu, edhe vërejtjet dhe sugjerimet e ekspertëve të fushës së drejtësisë, deri në leximin e dytë të projektligjit, besoj se do ta kemi një ligj të kompletuar, që do të mundësojë funksionimin normal të Akademisë së Drejtësisë, kurse praktikuesit e ligjit që do të kalojnë nëpërmjet kësaj akademie do të pajisen me dije, e cila është në funksion dhe shërbim të ngritjes së kualitetit të punës, efikasitetit, përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar deputetë! Përfaqësuesi i Qeverisë, në qoftë se kërkon fjalën? Tani jemi në fazën e deklarimit me votim. Jemi 45 deputetë.

I nderuar ministër,
Kolegë të nderuar, deputetë,
Edhe mediet të cilat janë,
Dëshiroj vetëm ta evidentoj një fakt.

Janë 72 nënshkrime të cilat kanë ardhur për mëditje, 72 veta kanë ardhur për mëditje, por për përgjegjësinë për deputetë asnjëherë sot në këtë sallë nuk kanë qenë mbi 54-55. Keni parasysh, populli na ka zgjedhur, le të na njohë çdokush çfarë jemi. Faleminderit!

Do të takohemi... Jo, jo, nuk kam të drejtë, i kam edhe kolegët e Kryesisë, nuk kam të drejtë të nxjerr Rregulloren të re, por për publik mjafton të shihet, vetëm se asnjëherë s'kanë qenë në sallë mbi 54 deputetë, përkatësisht 5, le të themi se unë kam gabuar një. 72 deputetë janë të nënshkruar për mëditje. Faleminderit!

Takohemi në seancën e radhës. Se kur do ta vazhdojmë, Kryesia merr vendimin. Faleminderit!

Deputetë që jeni të pranishëm, largojini kartelat, më mirë merrini me vete, mos i lini, se i kemi 62 deputetë me kartela në sallë edhe në këtë moment. Merrini me vete, për çdo rast. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*